


Antropologjia Politike e Identitetit

- Rasti Amerikan -



Brenton Kotorri

ANTROPOLOGJIA POLITIKE E IDENTITETIT
- RASTI AMERIKAN -

Brenton KOTORRI

Qershor 2016

ABSTRAKTI

Studimi i antropologjisë së identitetit politik është sot, në Shqipëri, në fazën para-pioniere. Kjo vepër synon të krijojë një themel modelor lidhur me studime të ngjashme tejet të nevojshme për disiplinën. Në këtë punim, do të mund të shihet se si ndërtohet ndërgjegjia e përbashkët e një komuniteti. Sesi ky komunitet e ndërton identitetin e vet politik përmes ligjërimit të elitave, dhe sesi më pas e projekton këtë identitet politik në raport me popuj të tjerë. Ky studim heton rastin e SHBA-së, që në tekst do ta gjeni shpesh edhe si Amerika.

Që prej ardhësve të parë në kontinentin e ri, e deri tek Amerika si superfuqi botërore, u deshën 150 vite histori. U deshën edhe 70 vite që Francis Fukuyama dhe entuziastë të tjerë të deklararin se SHBA-ja si model i demokracisë liberale kishte dhënë shembullin se si e gjithë bota duhet të jetë. I gjithë ky inkursion, mund të shpjegohet më së miri vetëm përmes antropologjisë së formësimit të identitetit politik. Kjo do të na japë në dorë, veglat e duhura për të kuptuar të pandërgjegjshmen anë të historisë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

- 1- Hyrje**
- 2- Si krijohet fryma e përgjithshme?**
 - **Krijimi i shtet-kombit në aspektin historik**
 - **Krijimi i ndërgjegjes para-kombëtare amerikane**
- 3- Krijimi i shtet-kombit amerikan**
 - **Krijimi antropologjik i Amerikës**
 - **Krijimi politik i Amerikës**
 - **Aspekti socio-kulturor i popullit amerikan**
- 4- Krijimi i identitetit politik amerikan**
 - **Krijimi i identitetit popullor**
 - **Krijimi i identitetit politik përmes ligjëritimit**
 - **Projektimi në marrëdhëniet ndërkombëtare**
- 5- Përfundime**

KAPITULLI I: HYRJE

“Kombet Europiane nuk janë, dhe nuk mund të jenë si ju. Ato janë produkt i historisë dhe jo filozofisë. Mund ta ndërtohet një komb mbi një ide, por nuk mund të rindërtohet një komb mbi bazën e një kombi tjetër”. Këto rreshta të fjalimit të Kryeministres britanike Margaret Thatcher drejtuar amerikanëve¹ shprehin idenë më të qartë lidhur me identitetin politik të Sh.B.A-së në arenën ndërkombëtare. Europa ka lindur nga historia ndërsa Amerika nga filozofia.

Periodha e fill pas zbulimeve të mëdha gjeografike, shtroi rrugën për Reformën Luterane, e cila shtroi rrugën për krijimin e shtet-kombeve dhe Traktatit të Vestfalisë, iluminizmi u përhap dukshëm si religjioni i ri i kontinentit dhe kjo shtroi rrugën për Revolucionin Amerikan dhe luftën e 13 kolonive të para për pavarësi prej kurorës britanike.

Historia e themelimit dhe zhvillimit të Amerikës, si konstrukti i parë i një shtet-kombi nga fillimi, ka qenë dhe mbetet një prej fenomeneve më të vëzhguara në aspektin politik, social, ekonomik, institucional, diplomatik, ushtarak, kulturor, etj.. Përgjatë shekujve të shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë, amerikanët zhvilluan një sistem qeverisjeje me koncepte dhe ide që nuk ishin aplikuar tjetërkund më parë në histori. Amerikanët adoptuan një sistem përfaqësimi me parime demokratike që e lejonte cilindo qytetar që të kishte zë në qeverisjen e vendit ku jetonte.

Kjo atmosferë e ideve të reja dhe garantimit të të drejtave qytetare formësoi një lloj ndjesie uniciteti tek identiteti amerikan në raport me kombet e tjera të asaj kohe. Në vigjilje të themelimit të Sh.B.A-së si një shtet i pavarur prej britanikëve, kolonët kishin përfaquar tashmë një identitet të formësuar rishtazi dhe thujtë të shkëputur prej rrënjëve europiane dhe kjo ndihmoi në forcimin e shkallëzuar të rezistencës ndaj kurorës. Gjatë shekullit të

¹ Fjalim në drekën e mbajtur për Hoover Institute, Stanford University.
<http://ëëë.margarethatcher.org/document/108264>

tetëmbëdhjetë amerikanët patën mjaftueshëm liri prej Britanisë sa për të zhvilluar një sistem të tyrin politik të bazuar tek merkantilizmi. Institucionet e reja demokratike qytetase që amerikanët kishin ngritur nga hiçi, u mundësuan amerikanëve që të formësonin një identitet të mëvetshëm politik. Megjithatë kishte edhe faktorë të tjerë që ndikuan në këtë formësim, faktorë që ky punim do t'i ezaurojë përmes analizës së secilit.

Sebepi i jashtëm i ndezjes së ndjenjave të hapura anti - koloniale ndaj britanikëve ishin gjeeste si “The Stamp Act (Ligji i Pullës - 1765)” që i ofendoi amerikianët dhe sistemin e tyre të taksimit, apo “The Tea Tax (Taksa e Çajit) që i bëri amerikanët të shpallnin hapur sloganin historik “No taxation without representation (Nuk ka taksa pa përfaqësim)”. Megjithë konstruktin e këtij identiteti të ri që shfaqet fort në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë, kolonitë ende ishin të përçara për shkak të interesave monetare. Në njërin krah ishin patriotët dhe shumica e popullit të thjeshtë, dhe në krahun tjetër, ishin luajalistët që bënë thirrje për bindje ndaj kurorës mbretërore. Historia na e ka treguar se si identiteti i ri politik mbizotërori dhe Sh.B.A-ja jo vetëm që u shkëput prej Mbretërisë Britanike, por e forcoi aq shumë identitetin e vet politik, sa që projektimi i këtij identiteti në marrëdhëniet ndërkombëtare u bë gjithnjë e më i dukshëm dhe gjithnjë e më i nevojshëm.

Se si identiteti amerikan kaloi në tranzicionin nga një komunitet me parime të filozofisë iluministe dhe të doktrinës së krishterë, në një superfuqi ushtarake që shihet si polici i botës, do ta shohim të shtjelluar në këtë punim. Të gjitha stadet e formësimit, shpalljes dhe pranimit të përbotshëm të aspektit unik të identitetit amerikan, do të shpalosen përmes ngjarjeve historike dhe përmes përsiatjeve të vëzhguesve më të mëdhenj politikë si Burke, Tocqueville, Anderson, Paine, Wendt, Maldwyn, etj.. Kjo vepër, synon të vërtetojë se identiteti, ligjërimi politik dhe kapitalizmi i shtypit kanë bërë të mundur që Amerika ta projektojë vetveten në botë jo thjesht si një shtet-komb ndër të tjerë, por si një fenomen i idealit të lirisë dhe demokracisë. Duke iu përgjigjur kështu pyetjes kërkimore, se si arritën amerikanët që përfytyrimin për vetveten e projektuan si përfytyrim të botës për Amerikën.

Antropologjia studion mbi të gjitha kompleksitetin dhe nuancat e ndërveprimit dhe kulturës njerëzore. Përmes qasjes së konstruktivizmit social të antropologjisë politike, do të kemi mundësi që në këtë punim të vlerësojmë se si kultura ndërtohet përmes ligjërimit politik, dhe se si kjo kulturë formëson identitetin politik. Antropologjia kulturore, që është edhe qasja të cilën ne do të adoptojmë në këtë punim, është disiplina antropologjike që studion edhe historinë e kulturës. Përmbledhur në një përkufizim të Edward Burnett Tylor-it 1871, *“Kultura ose civilizimi, konsideruar në aspektin e gjerë etnografik të fjalës, është ajo tërësi komplekse që përfshin dinjitetin, besimet, artin, moralin, ligjet, traditën dhe cilindolloj tjetër zakoni, sjelljeje apo aftësie të fituar prej njeriut si anëtar i shoqërisë”* Ky punim synon që të vërtetojë indirekt, përmes rastit amerikan, se identiteti politik i popujve është një konstrukt social-kulturor, që ka si mjet kryesor ligjërimin e elitave; si përgjigje kjo ndaj teorive nacionaliste dhe racë-supremacistë. Konstruktivizmi ngrihet mbi premisën se bota sociale është një konstrukt social, dhe kjo është e vërtetë edhe për Marrëdhëniet Ndërkombëtare (Jackson & Sorensen, 2009:307)

KAPITULLI II: SI KRIJOHET FRYMA E PËRGJITHSHME (Common Sense)

1. Krijimi i shtet-kombit në aspektin historik

Për të mbërritur deri tek krijimi faktik i sistemit botëror të shtet-kombeve, është me rëndësi të përshkruajmë se si lindi nevoja për krijimin e tyre. Sipas Benedict Andersonit, mundësia fillestare për imagjinimin e kombit si komunitet erdhën pas rënies së tri koncepteve qendrore në historinë qendrore të njerëzimit. “Së pari, - thotë ai, ra koncepti se një gjuhë e vetme kishte monopolin e të vërtetës ontologjike (dhe transhendentale)” (Anderson, 2013:49). Këtu nënkuptohet ideja e komunitetit të bërëbashkët të krishterë (Kristendomit) përmes Latinishtes, e cila mendohej si gjuha e vetme në të cilën fliste Zoti, apo përdorimi i Greqishtes, Hebraishtes, Arabishtes, si gjuhë që pretendohet prej secilit komunitet autentik se i ka përzgjedhur Zoti për t’iu folur gjithë mëkëmbësve të tij në tokë. “Së dyti, - thotë Anderson, rrëzimi i idesë se shoqëria njerëzore është krijuar për t’u strukturuar nën një shtresëzim rrethor të natyrshëm të përqendruar tek monarku, aristokracia e tij, fisnikëria, etj. [...] Së treti, humbi koncepti se kozmologjia dhe historia ishin një dhe të pandara.” Praktikisht, Zoti nuk fliste më vetëm në një gjuhë, Zoti nuk fliste më vetëm përmes klerit, Zoti nuk qeveriste më përmes monarkut, dhe Zoti nuk kishte providencë.

Si u rrëzuan këto të vërteta? Që prej fillesave të shoqërisë të së shenjtës, ose për referencë kronologjike, shoqëria njerëzore që jetoi në epokën tradicionale, u dalluan disa karakteristika universalizuese që përcillnin mesazhin hyjnor për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohërat. Një karakteristikë e kësaj shoqërie është që nis me një moment vendimtar për historinë botërore. Së pari pas katër shekujsh përpjekje u pranua zyrtarisht Krishtërimi si fe, u ngrit kisha katolike dhe nisi përhapja apo evangjelizimi, duke u shtrirë kështu në të gjithë skajet e Europës por edhe më gjerë. Pra Krishtërimi zaptoi linjën qendrore të historisë së njerëzimit. Vetëm dy shekuj më pas, po brenda kësaj epoke lindi edhe Islami midis Europës dhe Lindjes së Largët, i cili po ashtu u përhap në mënyrë të shpejtë në të gjithë rajonin duke

ngritur edhe Kalifatin si institucion administrativ. Në copëza të tjera të botës kishim kudo besime tradicionale të cilat bartnin veçori po aq interesante. Në këtë kohë, pushteti i takonte pikërisht dogmës fetare. Me dogmë do të kuptojmë një doktrinë e cila provon të përhapet në shoqëri pa sjellë argumente apo evidenca objektive, por duke u imponuar si e vërtetë bazuar tek vetë brendia e saj dhe tek prezumimi i zbritjes nga Lartë. Pra e vërteta fetare është njëkohësisht e shenjtë. Duke qenë e shenjtë është e paprekshme dhe e pamanipulueshme nga njeriu. Rrjedhimisht njeriu përballë të vërtetës së shenjtë ka dy mundësi: ose ta pranojë pa kushte këtë të vërtetë dhe të ngrejë vizionin jetësor në përputhje me këtë, duke mos kërkuar objektivitet apo racionalizim, ose të refuzojë të vërtetën duke e sfiduar atë a)intelektualisht, me teza argumentuese; b)vulgarisht, duke e neglizhuar. Kështu, individët që jetonin në këtë kohë e pranonin të vërtetën ashtu siç u jepej nga kleri dhe siç u imponohej nga monarku. Ata që tentuan disidencën përfundonin në lloje të ndryshme inkuizicioni pasi sulmi ndaj dogmës konsiderohej si sulm ndaj vetë Hyut. Praktikisht, institucioni fetar me tagrin e mëkëmbësit të të vërtetës, merrnin lirinë për të gjykuar çdo konflikt dhe autoriteti i tyre, edhe pse duhet të ishte vetë e vërteta, ishte në fakt forca. Dhe shumë shpejt, forca dhe pasuria u kthyen në pushtet politik. Perandoria e Shenjtë Romane Gjermane për një mijë vjet (25 dhjetor 800 - 1806) taksoi dhe sundoi te gjithë popujt politikë të Europës. Pa miratimin e Papës askush nuk kishte autoritet mbretëror. Pa i dërguar Papës taksa dhe dhurata, askush nuk mbijetonte dot në fron. Në këto kushte, princërit dhe mbretërit me pak pushtet, mezi prisnin që të shpëtonin prej këtij sistemi.

Pasuesja e shoqërisë të së shenjtës, ishte shoqëria moderne. Kjo shoqëri erdhi për të shkatërruar të mëparshmen. Kalimi midis dy shoqërive ndodhi në një fragment kohe i cili ishte i mbushur me goditje vendimtare ndaj të vërtetës dogmatike. Raste të tilla ishin zbulimi se toka ishte e rrumbullakët dhe jo e sheshtë sikurse në përmbajtjen e të vërtetës së mëparshme. Zbulimi se sistemi diellor ishte heliocentrik dhe jo gjeocentrik. Zbulimi se indulgjencat nuk pastronin jetën mëkatore. Kjo goditje ndaj dogmës teologjike që kishte pasur për frymëzues dhe sistemizues Shën Augustinin dhe Shën Thoma Akuinin, erdhi për shkak se kleri kishte marrë përsipër që përveç verdikteve lidhur me jetën shpirtërore, të jepte

edhe verdikte lidhur me botën fizike. Praktikimi i përkthimit të Biblës që pas 95 tezave të Martin Luterit, i bëri njerëzit të kuptonin se dogma fetare kishte shkuar shumë shumë larg prej mesazhit thelbësor të librit të shenjtë. Të gjitha këto çuan në dobësimin e menjëhershëm të pushtetit shpirtëror të Kishës, por sidomos të atij politik.

Fill pas shpalljes së protestës luterane ndaj dogmës katolike, princërit gjermanikë dolën në krah të lëvizjes së re. Jo aq për arsye fetare sesa politike². Këta monarkë mbështetën me financa dhe mjete, fshatarësinë e tyre për të realizuar një seri kryengritjesh ndaj Papatit dhe Perandorit, të cilat çuan në një luftë tridhjetëvjeçare midis Protestantëve (Luteranëve) të rinj dhe Katolikëve që po kalbëzoheshin. Në Britani gjithashtu, lufta civile u nxit mes luajalistëve dhe anglikanëve me Oliver Kromuellin në krye. Këto luftëra fetare – politike që çuan për tridhjetë vite në vdekjen e 8 milionë personave (Davies, 1996:568), u mbyllën me Paqen e Vestfalisë. Traktatet Münster dhe Osnabrück të njohura përgjithësisht bashkë si Traktati i Paqes së Vestfalisë (1648), sollën vendosjen e kufijve të rinj politikë për shtetet e Europës. Tanimë, përmes parimit latin *cuius religio, eius religio* (religjioni i prijësit është religjioni i popullit) princërit gjermanikë kërkuan kompaktësimin: një gjuhë-një popull-një territor-një religjion-një shtet.

Këtu nis për herë të parë koncepti i shtet-kombit, koncepti politik i cili ndryshoi përgjithmonë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe gjithë fytyrën e globit. Koncepti politik për të cilin kanë vdekur në të gjitha luftërat nacionaliste me miliona jetë njerëzish. Ndërkohë, në kontinentin amerikanoverior, përgjatë fundit të shekullit të gjashtëmbëdhjetë dhe fillimit të atij të shtatëmbëdhjetë, Anglia, Franca, Spanja dhe Holanda kishin nisur programet e kolonizimit (Cooke: 1998). Këto koloni korrkohej të instaloheshin në Kontinentin e Ri për qëllime përfitimi përmes tregëtimit të lëndës së parë (sidomos duhanit, kafesë kakaos etj.).

² Encyclopaedia Britannica: Martin Luther <http://www.britannica.com/biography/Martin-Luther> (parw pwr herw tw fundit mw 12 qershor 2016, 11:00.)

Kolonia e parë konsiderohet të jetë Jamestown, Virginia (1607)³, (Qyteti i Xhejmsit, për nder të mbretit). Një prej momenteve më interesante në historinë e kolonive sikurse përshkruhet nga Alexander Young (1841), është Kompalti i Mayflower-it. Ky i fundit ishte një kontratë sociale e formës më të thjeshtë që i detyronte udhëtarët pelegrinë të anijes Mayflower që të qëndronin bashkë si një komunitet edhe pse disa prej anëtarëve të ekuipazhit doni të ishin të lirë nga pushteti i mbretit. Këta rebelë, përfaqësojnë këtu edhe frymën e përgjithshme (common sense) të të gjithë kolonëve të Kontinentit të Ri. Këta pelegrinë, zbritën në Massachusetts, dhe themeluan koloninë e tyre aty, bazuar tek e para kontratë sociale që realizohej nga një komunitet, që do të vetëqeverisej në njëfarë mase prej ligjeve të veta në territorin e mbretit. Shumica e këtij komuniteti me kalimin e viteve do të evangjelizonte në puritanizëm edhe pjesën më të madhe të të gjitha kolonive të New England-it (Anglisë së Re). Më tej, do të flasim edhe në kapitullin III të këtij punimi.

Ajo që duhet shënuar tjetër për përmbylljen e kësaj pjese të kapitullit, është kronologjia e zhvillimit të shtetit komb pas shekullit të shtatëmbëdhjetë. Zhvillimi i nacionalizmit në Francë, Britani, Amerikë, si dhe marrëdhënia me kolonitë Europiane në Afrikë dhe Azi, e mbajtën shekullin e tetëmbëdhjetë në një tension të vazhdueshëm. Luftërat napoleoniane, Koncerti European, bashkimi i Gjermanisë dhe Italisë dhe forcimi i Perandorisë Ruse, u pasuan prej Luftërave Botërore I, II. Rënia e regjimeve komuniste në pjesën më të madhe të botës, i reformësuan edhe njëherë kufijtë e shtet-kombeve dhe konceptin në vetvete.

³ Ditari i themelimit tw Jamesto32n-it

<http://nationalhumanitiescenter.org/pds/amerbegin/settlement/text1/JamestownPercyObservations.pdf> (parw pwr herw tw fundit mw 12 qershor 2016, 11:30)

2. Krijimi i ndërgjegjes para-kombëtare amerikane

Qysh prej nisjes së eksploratorëve të parë drejt Tokës së Re, bashkë me aventurierët dhe detarët guximtarë, në udhëtime kishte marrë pjesë edhe kleri fetar. Kësisoj, edhe në kolonitë e reja të përtejdetit, tradita e shoqërisë fetare ishte e vetmja e njohur. Po kështu, edhe pas themelimit të qyteteve të para, kisha ishte vendi ku të gjithë takoheshin më shpesh sesa kudo tjetër. Pastorët puritanë, Luteranë e Calvinistë që ishin arratisur prej persekutimeve në Kontinentin e Vjetër në mënyrë që në të Riun të ndihmonin ndërtimin e një shoqërie më të pastër e më përfekte me Zotin në qendër, vijuan të bënin thirrje për ndërtimin e atij “*Qytetit të Shndritshëm në majë të Kodrës*”⁴. Amerikani do të ishte “Adami i Ri”, dhe Amerika do të ishte “Edeni i Ri”. Pastorët e parë të kolonive amerikane, sidomos gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë kur kolonitë nga ngjizja po kalonin në rritje, u kujdesën që kjo shoqëri e re të ngrihej mbi parimet e pastra protestante puritane. Sikurse kemi theksuar paraprakisht, Kisha Katolike kujdesej që t’i mbante njerëzit nën pushtetin e papës, ndërkohë që puritanët protestantë u kujdesën që t’ua kthenin pushtetin sërish njerëzve. Kësisoj, edhe për ata që në kontinentin e vjetër vuanin persekutim, Amerika u bë toka e ëndrrave, për shkak se njerëzit do të jetonin të lirë në besimin e tyre. Pastorët më në zë të kolonive gjatë shekullit të shtatëmbëdhjetë ishin: Richard Mather, John Winthrop, Anne Hutchinson, George Whitfield, Roger Williams, apo më vonë Joseph Smith, themeluesi i Mormonizmit.

BESIMI DHE RACIONALIZMI

Gjatë shekullit , në Amerikë u dyndën disa qindra mijëra besimtarë të denominacioneve të ndryshme protestante si përsëmbull Baaptistë, Calvinistë, Presbiteranë, Kuekeristë, por edhe Çifutë, Katolikë e Anglikanë. Anglikanët, u dërguan në Amerikë kryesisht për të vijuar dominimin shpirtëror të Britanisë së Madhe edhe në

⁴ Kjo metaforë e famshme në politikën amerikane edhe të ditëve të sotme, rrjedh prej mesazhit që Jezusi u dha të krishterëve në “Ceremoninë në Mal” Mateu 5:14, duke i paralelizuar ata si dritën e një qyteti në majë të kodrës që të gjithë e shohin me admirim.

kontinentin e Ri që dukej tashmë i distancuar prej origjinës së vet europiane. Mbreti i garantoi Virxhinias një Kartë të Drejtash në vitin 1624, por njëkohësisht u kërkoi atyre të pranonin Kishën Anglikane si autoritet⁵. Duke bërë kështu, u vendos edhe një licencë e detyrueshme në të gjitha kolonitë për këdo që donte të predikonte jashtë kishës Anglikane, kjo u bë sigurisht në mënyrë që të dekurajoheshin protestantët. Në vitet që pasuan, deri në afrim të revolucionit, Virxhinia u bë shembulli i përpjekjeve për të rifituar liritë fetare duke dënuar persekutimet e pastorëve protestantë. Mes viteve 1680 – 1760, Anglikanizmi u përcaktua me mbështetjen e kurorës si religjioni zyrtar i shumicës së kolonive. Në dekadën e tretë dhe të katërt të shekullit të tetëmbëdhjetë, fiks në vigjilje të revolucionit amerikan, ndër koloni, pastorët nisën intensivisht një thirrje për rikthim tek vlerat puritane që u njoh më pas si Zgjimi i Madh. Në këtë periudhë u dalluan tri grupime që kërkonin të influenconin marrëdhënien midis shtetit dhe kishës ndër koloni: Tradicionalistët, që besonin se marrëdhënia e ngushtë mes kishës dhe shtetit ishte e vetmja formë për të garantuar rendin social; racionalistët me në krye Tomas Xhefersonin dhe Xhejms Medisonin, të cilët bënë thirrje për ndarje totale të shtetit prej kishës; dhe disidentët, (presbiteranë, baptistë, metodistë, etj.) që e shihnin pushtetin politik të shtetit si rrezik për korrupsionin e shpirtit. Identiteti politik, social dhe fetar i amerikanëve ishte në udhëkryqin më të vështirë që prej kohës së ngulitësve të parë.

Përveç përpjekjeve të pastorëve protestantë për të formësuar identitetin amerikan, u përpoqën përmes fjalimeve të tyre edhe shumë politikanë të kohës. Sidoqoftë, si tek klerikët, ashtu edhe tek politikanët mund të gjeje si luajalistë ashtu edhe independentistë. Kësisoj njerëzit po përballëshin me një moment kyç për formësimin final të identitetit të tyre politik. Dilema ishte nëse do të bindeshin përfundimisht nën mbretin si pjesë e Britanisë, apo nëse do të mëvetësoheshin drejt vetëqeverisjes. Për të dhënë një pamje të ideve politike që qarkullonin asokohe, do të shqyrtojmë rastin e filozofit Tomas Pein.

⁵ Kisha Anglikane e Virxhinias, <http://www.pbs.org/godinamerica/people/virginia-experience.html> (Parw pwr herw tw fundit mw 15 qershor 2016, 13:30.)

Tomas Pein (Thomas Paine), kishte udhëtuar drejt Kontinentit të Ri i nxitur prej këshillës së Benxhamin Frenklinit (Benjamin Franklin). Frenklin i pat sugjeruar Peinit që të zhvendosej drejt Amerikës, për ta filluar nga e para, duke qenë se në Ishull ai kishte dështuar në karrierë⁶. Pas vendosjes në amerikë ku nisi të punonte në gazetë, Pein gjeti kohën për të shkruar “Fryma e Përgjithshme” (Common Sense, 1775), pamfleti më i famshëm i para-revolucionit i cili do të nxiste një frymë të përgjithshme rebelimi ndaj kurorës. Ky pamphlet politik shtjellonte një argumentim këmbëngulës dhe pasionant për pavarësinë e kolonive, gjë të cilën askush më parë nuk e kishte marrë shumë seriozisht.

Në kapitullin III të këtij pamfleti, të titulluar “Mendime mbi gjendjen aktuale të Amerikës”, Pein shqyrton përplasjet e deri asokohshme midis Britanisë dhe kolonive amerikane, në këtë perspektivë ai argumenton se rruga e vetme është pavarësia. Pein propozon një *Kartë Kontinentale*, ose një *Kartë të Kolonive të Bashkuara* që do të shërbente si një *Magna Carta* (1215) amerikane. Pein vijon më tej duke hartuar edhe një skemë konkrete për organizimin e strukturës ekzekutive të qeverisjes. Në kapitullin III të këtij pamfleti të titulluar “Mbi mundësitë aktuale të Amerikës, shoqëruar me reflektime të ndryshme”, ai shkruan (Paine, 2014:64-65):

“Nëse Kontinenti do të ishte i mbushur me banorë, vuajtjet nën rrethanat e tanishme do të ishin të pa tolerueshme. Sa më shumë qytet-porte kemi, aq më shumë kemi për të fituar dhe humbur. Numrat tanë të tanishëm janë përsosmërisht në përpjesëtim më dëshirat tona, sa të gjithë do kenë më ç’ të merren. Zvogëlimi i tregtisë ofron një ushtri, dhe nevojat e një ushtrie krijojnë nevojën për tregti të reja. Borxhe nuk kemi dhe çdo gjë që mund të bëjmë në këtë aspekt do të shërbejë si një kujtim i laodishëm i virtytit tonë. Nëse do jemi në gjendje të lëmë pasardhës me një formë të vendosur të qeverisë, një kushtetutë të pavarur të vetën, pagimi i çdo lloj çmimi do të jetë i lirë.”

⁶ Letwr e Frenklinit pwr Pejin <http://www.wallbuilders.com/libissuesarticles.asp?id=58> dhe <http://www.benjaminfranklinhouse.org/site/sections/about/franklin/Issue%209%202003-2004%20The%20letter%20that%20changed%20the%20world.pdf> (Parw pwr herw tw fundit mw 14 qershor 2016, 10:30.)

Në këtë kapitull, Pein shfaq vizionin e vet optimist mbi potencialin ushtarak të Amerikës në kohën para revolucionit, dhe kërkon që t'i ngacmojë kolonët tek ideja e tregtisë, që për ta ishte jetike. Ai për shembull shkruan faqe të tëra për të argumentuar se si punishtet koloniale të anijeve, duke përdorur lëndën shumë të madhe drusore të kontinentit do të mund të ndërtonin me shpejtësi një flotë detare e cila mund të rivalizonte edhe Flotën Mbretërore, që në atë moment ishte më e fuqishmja në botë.

Në periudhën fill para revolucionit, kolonitë kishin arritur në një popullsi prej 2.5 milionë banorësh (QNK, 2010:53). Dhe ata fare mirë mund të portretizoheshin në pyetjen retorike të J. Hector St. John de Crevecoeur (1782) "Çfarë është atëherë amerikani, ky njeri i ri?" Ndërkohë që kolonët amerikanë, tashmë përbënin një popull, ja se si përshkruhen në "Outline of U.S. History - 2011:34" konceptet kyç rreth të cilave u identifikua ky popull në kontrast me Europën, si një rast sui generis:

"Në Europë, idealet e të drejtave të individit përparuan ngadalë dhe me ritme të pabarabarta; ndërkohë, koncepti i demokracisë ishte shumë herë më i huaj dhe i panjohur. Lufta për t'i shkruar këto të dyja në shtetin më të vjetër të Europës kontinentale shkaktoi shpërthimin e Revolucionit Francez. Përpyekja për ta shkatërruar shoqërinë neo-feudale duke respektuar të drejtat e njeriut dhe vëllazërinë demokratike, solli terror diktaturë dhe despotizëm napoleonian. Në fund kjo shkaktoi kundërvëprimin zyrtar dhe kësisoj legjitimoi rendin e vjetër. Në Amerikë, të shkuarën e Europës e tronditën ideale që buronin natyrshëm nga procesi i ndërtimit të një shoqërie të re në një tokë të virgjër. Parimet e liberalizmit dhe të demokracisë ishin të fuqishme që në krye të herës. Shoqëria e cila kishte hequr në shpinë barrën e historisë së Euroës, do të lindte natyrshëm një komb që e quajti veten të jashtëzakonshëm."

Bashkë me shpirtin aventurier, kolonët kishin marrë me vete drejt Amerikës edhe idetë e reja të epokës së re iluministe. Kësisoj, përkrah ideve për shkëputje shpirtërore prej Kishës Anglikane dhe kësisoj, Mbretit, amerikanët ishin mbujtur edhe me nevojën për liri politike prej Mbretit. Në aspektin shpirtëror, amerikanët gjithnjë e më shumë po e refuzonin

idenë se mbreti kishte autoritet hyjnor dhe se ai qeveriste me frymëzimin e Zotit. Në aspektin racionalist amerikanët ishin ushquer tashmë me idetë e Grotius (1609), Locke (1689), Montesquieu (1748), apo Hume (1752) që u përkthyen në plane veprimi në mesin e shekullit nga Tomas Xhefersoni, Xhejms Medisoni, Benxhamin Frenkilini apo Aleksandër Hamiltoni. Përfaqimi i menjëhershëm i këtyre ideve, pa braktisur besimin e fortë në Zot, e bën amerikën, një prej modeleve më të rralla të bashkëjetesës së modernitetit me religjionin. Kësisoj, prej frymëzimit të “Utopia”, “Qyteti i Diellit”, “Atlantida e Re”, nga njëra anë, dhe prej evangjelizimit të vazhdueshëm të Zbulesës prej pastorëve amerikanë, identiteti i këtij populli të ri po formësohej me frymën e përgjithshme se *ata ishin populli i zgjedhur i Zotit që duhet ta ndërtonin nga themelet qytetin e shndritshëm në kodër.*

Sigurisht, hapi i parë do të ishte liria. Ashtu sikurse Zoti i kërkoi Moisiut që t’i nxirrte izraelitët nga skllavëria në Egjipt, ashtu edhe amerikanët duhet të çliroheshin nga sundimi i kurorës. Një rrjedhë ngjarjesh çuan në mobilizimin mbarëpopullor kundër Britanisë.

NGJARJET

Së pari: Pasi fituan luftën Franko-Indiane, Britanikët e shtuan kontrollin dhe diktatin e tyre mbi kolonitë si pjesë e një plani të ri strategjik për përdorimin e kolonive si burim fitimi direkt prej taksave (Powell, 2005:204). Kësisoj, veprimi i parë ishte vendosja e Taxës së Pullës (Stamp Act) (1765). Kjo taksë kërkonte që çdo gazetë, çdo afishe, çdo pamflet, çdo licencë, çdo akti qiraje apo dokument tjetër ligjor, të pajisej më pullën e të ardhurave. Kjo taksë u tha se do të përdorej për “mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e kolonive” (Draper, 1996:216-217). Duke qenë se vepronte njëlloj mbi këdo profesion, Taksa e Pullës (ose Akti Parlamentar i Pullës) ngjalli armiqësinë e grupeve më kompakte dhe me më shumë influencë në popullsinë amerikane: të avokatëve, gazetarëve, biznesmenëve, klerikëve e tregtarëve. Tregtarët e fuqishëm u organizuan për të bërë rezistencë ndaj këtij Akti, sidomos kundër mallrave të importuara. Intelektualët u organizuan gjithashtu në shoqata (ndonjëherë të fshehta dhe të dhunshme). Këto grupime iu ushtruan prision doganierëve dhe taksambledhësve që të dorëhiqeshin prej detyrës duke e shkatërruar kështu praktikisht

procesin. Gjatë po këtij viti, asambleja e Virxhinias me iniciativë të delegatit Patrik Henri⁷, vendosi për mosrespektimin e Taksës së Pullës me argumentin se nuk mund të respektohej asnjë taksë përveç atyre që miratonte vetë kolonia. Pas kësaj, u mbledh në New York “Kongresi i Aktit të Pullës” me 27 përfaqësues nga 9 koloni. Aty, ata përfundimisht vendosën që nuk do të respektonin asnjë taksë tjetër përveç atyre që ata vetë i votonin, dhe e shpallën Taksën e Pullës si një veprim që kërkonte asgjësimin e lirive të individit. Për herë të parë amerikanët ishin të gjithë bashkë, dhe ishin amerikanë. Kjo rezistencë politike u shoqërua edhe me akte dhune. Në disa koloni, taksidarët e Mbretit u varën dhe ekzekutuan. Shtëpitë e tyre u bastisën. E gjithë rezistenca popullore dhe intelektuale e amerikanëve kishte çuar në tërheqjen e Britanisë prej këtij Akti. Në 1766-ën Parlamenti Britanik e shfuqizoi Taksën e Pullës. Sidoqoftë, duke rikonfirmuar autoritetin e tyre mbi kolonitë (Middlekauff, 2005:111–113) . Kjo ishte fitorja e parë madhore në rrugën drejt shkëputjes përfundimtare të një populli prej sundimit të kurorës së një populli tjetër. Tanimë, amerikanët ishin populli i ri që kërkonte të ndërtonte të ardhmen e vet, me ligjet e veta.

Së dyti: Ky moment shërbeu si një shprehje politik për të ngritur lart tezën “S’ka taksim pa përfaqësim” e cila fillimisht u ligjërua nga Patrik Henri dhe më pas u kthye në sloganin e nxitjes së shkëputjes. Praktikisht, amerikanët ngritën me këtë rast idenë se ndiheshin të papërfaqësuar prej Parlamentit Britanik për aq kohë sa ata nuk zgjidhnin asnjë prej përfaqësuesve të dhomës së komunëve. Këtu erdhi momenti kur liderët amerikanë shpallën se Mbreti ishte autoriteti i tyre, sikurse ishte edhe për parlamentin, por parlamenti nuk kishte asnjë autoritet mbi ta. Kësisoj, amerikanët nuk do t’i paguanin asnjë taksë britanike për aq

⁷ Patrik Henri (Patrick Henry), 1736 – 1799, ishte një prej zvrave mw tw fuqishwm tw revolucionit amerikan. Si një luftwtar i tw drejtave tw individit, lirisw dhe pronws private, ai mbahet mend pwr fjalimin e vet tw vitit 1775 tw titulluar “Give me Liberty or Give me Death!” (Jepmwni lirinw ose sillmwni vdekjen) ku thekson se: “...Kjo wshtw njw çwshtje lirie ose skllavwrie [...] Britania e Madhe nuk ka asnjw armik nw faqe tw dheut, dhe gjithw flota e ushtria e saj nuk shwrbejnw pwr asgjw tjetwr pwrveçse pwr tw na nwnshtruar ne. [...] Ne e kemi provuar tw argumentojmw me ta, por nuk ka funksionuar. A mos duhet tw nwnshtrohemi? [...] Nuk ka mw shpresw tjetwr pwrveçse tw luftojmw. Vetwm kjo na ka mbetur. [...] Tre milionw njerwz qw jemi, tw armatosur nw kauzwn e drejtw pwr liri, dhe tw ndihmuar nga Zoti i madh qw do t’i sjellw miqtw tanw (aleatw tregtarw tw kolonive) tw luftojnw pwrkrah nesh. [...] Lufta nw fakt ka filluar, dhe nuk ka mw paqe. Vwllzwrit tanw janw tashmw nw fushwbetew. [...] Mos wshtw vallw paqja kaq e wmbwl saqw ta paguajmw me çmimin e skllavwrimit. Mos e dhwntw Zoti! Nuk e di se çfarw rruge mund tw ndjekin tw tjerwt, por sa pwr mua, JEPMWNI LIRI ose JEPMWNI VDEKJE!”

kohë sa nuk kishin përfaqësim në parlament, duke përdorur kështu si mburojë Kartën e të Drejtave (The Bill of Rights - 1689).

Së treti: Samuel Adamsi (Samuel Adams), ishte një prej udhëheqësve më në zë të rebelëve në popull. Më 1772 ai krijoi takimin qytetar të Bostonit për të krijuar "Komitetin e Pajtimit" që do të paraqiste ankesat dhe kërkesat e kolonive. Një vit më pas, teksa Kompania e Indive Lindore kishte marrë monopolin e eksportimit të çajit në koloni. Të shtyrë prej humbjes së madhe, tregëtarët e pavarur të kolonive iu bashkuan radikalëve të Adamsit (Labaree, 1979:67-70). Natën e 16 dhjetorit një grup me burra të maskuar si indianë Mohoukut (QNK: 2010: 100), me në krye Adamsin, hipën në tre anije dhe e hodhën të gjithë ngarkesën e çajit, prej kuvertës në ujin e portit të Bostonit.

Edmund Bërk (Edmund Burke) 1729 - 1797, njihet në histori si babai i mendimit politik të djathtë konservator. Në vitin 1775 ai mbajti një fjalim në Dhomën e Komunëve në Parlamentin Britanik (Burke, 2007:30). Fjalimi bënte thirrje për një pajtim me kolonitë, si një tentativë e fundit e tij për të mbjellë idenë e paqes me Amerikën. Gjatë këtij fjalimi ai thekson se numri i kolonëve është tashmë shumë më i madh sesa kur aktet e para ligjore u nënshkruan. Thekson po ashtu shtrirjen e tregtisë ndërkontinentale të amerikanëve. Duke kërkuar kështu të thoshte se tashmë ata janë një popull i mëvetshëm. Megjithatë ai ruan balancën duke thënë se amerikanët mbajnë lart të njëjtat parime "*jo thjesht të lirisë në përgjithësi, por të lirisë sipas modelit anglez*". Ai sqaron se një anglez është personi më i papërshtatshëm për të bindur një anglez tjetër që të nënshtrohet si skllav. Fryma e fjalimit të tij bën thirrje për pajtim të menjëhershëm me kolonitë dhe kjo do të kërkonte disa lëshime prej kurorës. Kësisoj, për herë të parë Pein dhe Bërk bien dakord mbi vlerën e mëvetësisë së popullit amerikan, megjithëse ishin armiq në ideologji.

Amerikanët nuk mendonin, e nuk silleshin si britanikët, aq më pak, si ndonjë popull tjetër në Europë. Ata nuk jetonin më me të njëjtin organizim social që kishin jetuar në vendet e origjinës gjyshërit e tyre, pelegrinët e parë. Ata ishin AMERIKANË.

REVOLUCIONI

Më 4 korrik 1776, Kongresi, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shpalli mëvetësinë prej Perandorisë Britanike përmes “Deklaratës së Pavarësisë”. Një prej dokumenteve politike më të mëdha të njerëzimit me autor W vjeçarin Tomas Xheferson. Kjo deklaratë fuqizohet prej fjalëve: *“Ne i konsiderojmë këto të vërteta si të vetëkuptueshme, se të gjithë njerëzit janë krijuar si të barabartë e se ata janë mburrur prej Krijuesit të tyre me disa të drejta të patjetërsueshme, e midis tyre janë Jeta, Liria dhe rendja drejt Lumturisë”*. Në tërësinë e saj kjo deklaratë realizon tri objektiva thelbësore:

- 1- Parashtron kauzën e revolucionit të lidhur me të drejtat natyrore dhe përkufizon sovranitetin kombëtar.
- 2- Parashtron një listë të ankesave kryesore që kolonitë kishin vuajtur nën sundimin e kurorës.
- 3- Shpall bashkimin dhe pavarësimin e 13 kolonive të bregut lindor të kontinentit.

Kjo deklaratë, erdhi pasi një vit më parë, mëkëmbësit ushtarakë të kurorës në kontinent, dhe trupat qytetare në koloni, ishin përplasur me armë në Boston, Konkord, Kebek, dhe Nju Jork. Fill pas kësaj, Kongresi i Dytë Kontinental më 10 maj kishte votuar pro luftës ndaj Britanisë dhe kishin caktuar Kryekomandant të Forcave të Shteteve të Bashkuara, Kolonelin Xhorxh Uashington (George Washington).

Mes disfatash e fitoresh, ushtria e vogël dhe pa eksperiencë e Uashingtonit arriti që të sprapste dhe të mposhte disa herë trupat ushtarake Britanike në kontinent. Nga ana tjetër e oqeanit, Franca gëllonte prej entuziasmit intelektual që përcillte ky revolucion, ngase edhe francezët ishin ngopur tanimë me privilegjet e feudalistëve dhe borgjezisë. Me negociimin e Benxhamin Frenklinit, Franca u rreshtua krah amerikanëve dhe nisi t’u dërgonte atyre ndihma, pasi u sulmuan nga flota britanike anijet franceze, edhe Spanja u rreshtua krah francezëve. Britania i shpalli luftë edhe Holandës për shkak se ata e vijonin tregtinë me kolonitë. Bashkimi i këtyre forcave europiane i dhanë goditjen e fundit Britanisë (Fischer, 2005:185-188). Më 1783-shin, Britania pranoi të nënshkruante Traktatin e Paqes së Parisit që i njihte 13 kolonitë si të lira dhe të pavarura (Morris, 1965).

Pasqyra e mësipërme na mundëson deduktimin e tri fenomeneve jetike për identitetin politik amerikan:

- 1- Amerikanët realizuan për herë të parë harmonizimin e mësimeve të Biblës me frymën iluministe. Kësisoj ata u ndjënë gjithnjë e më shumë si të përveçëm prej popujve të tjerë.
- 2- Zhvillimi historik i konceptit dhe ngjarjeve që avancuan formimin e shtet-kombeve krijoi mjedisin për mëvetësinë e popullit amerikan në një territor me një shtet.
- 3- Për shkak të ligjërimit të elitës intelektuale, amerika arriti ta projektojë veten në marrëdhëniet ndërkombëtare jo thjesht si një shtet mes shtetesh, por si një ideal i vlerave të pastra të njerëzimit, të cilin të gjitha shtetet e tjera duhet ta mbronin.

Të trija këto fenomene, do ta shoqëronin Amerikën hde identitetin e saj, gjatë gjithë historisë së tri shekujve të fundit.

KAPITULLI III: KRIJIMI I SHTET-KOMBIT AMERIKAN

1. Krijimi antropologjik i amerikës

Sikurse kemi prekur pak më sipër, Amerika që në gjenezë u krijua si një konglomerat prejardhesh etnike, racore, e kulturore. Për të shqyrtuar krijimin e amerikës nga aspekti antropologjik do të shqyrtojmë influencën e secilit prej këtyre elementeve.

Heike Paul, në veprën e tij "The myths that made America" (Mitet që e krijuan Amerikën), parashtron të renditura mitet që e influencuan më së shumti identitetin amerikan, si elementin më të fuqishëm antropologjik: *Kristofor Kolombi dhe miti i Zbulimit; Pokahontas dhe miti i dashurisë transatlantike; Pelegrinët dhe puritanët, miti i Tokës së Premtuar; Pavarësia amerikane dhe miti i baballarëve themelues; Ekspansionizmi dhe Shkrirja në një; Miti i perëndimit amerikan; dhe Miti i suksesit prej individualizmit*. Besimi tek këto mite, sikurse do të argumentojmë edhe në kapitujt në vazhdim, ishte pjesë thelbësore e formësimit dhe vetëformësimit të identitetit politik amerikan.

Fillesat e ngulitësve të parë ishin të vështira në raport me vendasit indianë të cilëve pelegrinët po u pushtonin tokat. Për shkak të një konflikti të gjatë e të dhunshëm, ndërveprimet shoqërore mes indianëve vendas dhe kolonizuesve anglo-saksonë, ishin thuajse nul (Stevenson, 1989:17). Sidoqoftë, asokohe dallesat sociale ishin tejet të mëdha e të dukshme. Si në organizimin social, si në linguistikë, ashtu edhe në format dhe minierat e sjelljes, veshjes e të ushqyerit.

Kësisoj një harmonizim dhe asimilim ishte i pamundur ndaj dhe e vetmja formë që u ndoq ishte përndjekja e fiseve indiane shumica prej të cilëve u shfarosën. Teksa Amerika hynte në shekullin e njëzetë, kishin mbetur vetëm 250 mijë indianë të cilët jetonin në rezervate, ishin të varfër, të sëmurë, dhe pa asnjë perspektivë. Dukej se toponimitë kishin mbetur e vetmja gjurmë e tyre. Sot më shumë se gjysma e shteteve amerikane mbajnë ende emrat me prejardhje indiane. (Maldwyn, 1993: 9). Llogaritet ama se sot, jetojnë mbi 20 milionë njerëz me gjak të largët indian në Amerikë.

Kultura anglo-saksone erdhi në amerikë qysh prej gjenezës së kolonive. Mirëpo numri më i madh i emigrantëve erdhi në amerikë në gjysmën e shekullit të shtatëmbëdhjetë. Kjo valë kolonësh ishte shumë më lartë ekonomikisht, kulturalisht dhe intelektualisht sesa ngulitësit e parë. Ata vinin bashkë me familjet e tyre dhe shpesh tërhiqnin nga pas bashkë me pastorin edhe të gjithë famullinë e fshatit apo lagjes së tyre. Sikurse kemi cilësuar edhe më parë, këta kolonë ishin puritanë për nga besimi i tyre protestant. Sjellja, normat, zakonet dhe rregullat e tyre të përbashkëta rrjedhnin pikërisht prej këtij besimi dhe prej trashëgimisë së fortë të traditës së manierave e kortezisë britanike. Puritanët përfaqësonin të moderuarit që donin ta zhvishnin Kishën Anglikane nga të gjitha praktikatat katolike dhe evangjelizonin që njerëzit të jetonin jetën e tyre sipas Biblës dhe Ungjillit (Spraggon, 2003:98).

Sigurisht që për hir të tregtisë dhe përfitimit monetar, u ndërtuan menjëherë bashkë me kolonët edhe plantacionet e duhanit, kafesë, kakaos e bimëve të tjera. Kësisoj, kompanitë tregtare jo më vetëm britanike, por edhe holandeze, franceze nisën që të kërkonin nëpër europë krah pune. Këto kompani dërguan në amerikë me qindra bashkëkombas të tyre por edhe suedezë, danezë, gjermanë e pak spanjollë, portugezë e italianë të cilët mund t'i gjeje të shpërndarë ndër koloni (QNK, 2010: 53). Gjithashtu, disa gjykata në Britani nisën t'u jepnin të burgosurve si dënim alternativ punën e detyruar në plantacionet amerikane. Antropologu Franc Boas (Franz Boas) 1858 - 1942, në studimin e tij antropometrik të vitit 1912, thekson se pasardhësit e emigrantëve të parë në amerikë, kanë ndryshuar edhe fiziologjikisht prej stërgjyshërve të tyre (Boas, 1922). Në veprën e tij madhore të vitit 1940 të titulluar "Race, Language and Culture" (Raca, Gjuha dhe Kultura), ai parashtron se këto ndryshime kanë ndodhur për disa arsye të jashtme e sidomos mjedisi dhe mënyra e ndryshme e jetesës. Ai dallon gjithashtu se tre janë tipet e racave në kontinentin verior: a) ato me prejardhje europiane; b) përzjerjet e tyre me indianët vendas; c) përzjerjet e tyre me afrikanët; (Boas, 1940: 18). Boas argumenton se "*...martesat ndërraciale në kolonitë amerikane, kanë një tendencë homogjenizuese [...] Eksperienca tregon se pavarësisht rigorozitetit të kundërshtive shoqërore ndaj martesave të përzjera, ato nuk mund ta pengojnë asimilimin gradual të popullsisë*"

(Boas, 1940:W). Në argumentet e tij Boas shkon edhe më tej duke parashtruar ndryshime midis amerikanëve dhe britanikëve, që prej përdorimit të muskujve të fytyrës, masës trupore, gjymtyrëve por edhe se amerikanët e mbajnë nofullën e poshtme pak më përpara sesa britanikët. Me këtë panoramë analize, mund të kuptojmë se masat kolonëve, ishte tashmë edhe dallueshëm e ndryshme prej kolonizatorëve të tyre të dikurshëm.

Pas pak kohe në koloni erdhën edhe skllëvërit zezakë afrikanë. Vlerësohet të jenë rrëmbyer dhe transportuar vetëm drejt Amerikës së Veriut mbi 400 mijë skllëvër zezakë afrikanë. Të shpërndarë në të gjitha plantacionet e të gjitha kolonive, ata vuajtën sidomos trajtimin brutal të plantatorëve të jugut të kolonive. Shtete të cilat ishin të fundit në rezistencën kundër heqjes së skllavërisë deri në mesin e shekullit XX. Këta skllëvër vinin kryesisht prej brigjeve perëndimore të Afrikës, sidomos prej porteve të Senegalit të sotëm dhe Angolas. Skllavëria u kthye në një institucion shoqëror i cili u normativizua shumë shpejt për shkak të mbajtjes nën dhunë fizike dhe intimidim të vazhdueshëm të zezakëve që dukej sikur nuk ekzistonin përveçse në fushat e plantacioneve. Amerikanët nisën ta konsideronin tashmë dallimin e racës vetëm prej ngjyrës së lëkurës. Kur idetë antropologjike mbi racën u bënë popullore dhe kur konceptet popullore u bënë antropologjike, atëherë u legjitimua racizmi, ligjet e Xhim Krout⁸ (Jim Crow) (Drake, 1987; Drinnon, 1987; Smedley, 1993). Kësisoj, teksa indianët u vranë ose u asimiluan, pjesa tjetër e amerikanëve u homogjenizua përballë konceptit të "tjetrit" që ishin skllëvërit. Kështu, amerikanët nuk ishin "Ne", si një njësi homogjene vetëm në dallim prej Britanikëve të huaj, por edhe brenda kolonive ata ishin "Ne" përballë skllëvërve që ishin të huajt, e sigurisht nuk ishin aspak bashkëqytetarë (Dred Scott v. Sanfrod) të tyrët.

Gjuha angleze ishte homogjenizuesja pararendëse e aspekteve etnike dhe racore që sapo përshkruam. Gjuha, paçka prejardhjeve të ndryshme të komuniteteve linguistike nga Europa, kishte arritur qysh prej fillimit të vendosjes si gjuhë standarde, e përgjithshme dhe e përbashkët e kolonive. Ajo ishte gjuha e shkollave, e ligjeve, e politikës dhe e tregtisë. Me

⁸ Ligjet e Jim Crow <http://www.pbs.org/wnet/jimcrow/>

gjithë një përpjekje në 1795-ën për t'i përkthyer ligjet edhe në gjuhën gjermane, anglishtja vijoi të mbetej e vetme. Kjo supremaci i mbijetoi fillimisht spanjishtes dhe frëngjishtes, e më pas gjermanishtes, deri në ditët e sotme kur për shkak të numrit të madh të komunitetit jo spanjoll por amerikano-latin, shumë institucione përdorin si gjuhë të dytë (jo zyrtare) spanjishten.

2. Krijimi politik i Amerikës

Pas revolucionit, traktatit të Parisit dhe ratifikimit të kushtetutës (për të cilën do të flasim më tej), Shtetet e Bashkuara i ruajtën politikat e emigracionit të lirë. Emigrantët, shumë shpejt u kthyen në një faktor të rëndësishëm politik megjithëse asimilimi vazhdonte. Nga një vend prej 10 milionë banorësh në vitin 1820, Amerika arriti 100 milionë banorë në vitin 1920 (Fiorina, 1998:108) në 200 milionë sot dhe rritet me një person çdo 12 sekonda. (Census.gov). Bashkë me emigrimin e pas revolucionit, e deri më sot, sikleti prej emigrantëve që shtoheshin erdhi duke u rritur. Sidomos në shekullin e XX, emigrantët në Amerikë konsideroheshin si bartës të Bolshevizmit, Katolicizmit, Hebraizmit, Fashizmit, etj.

Kushtetuta Amerikane, e cila vijonte frymën Religjioze dhe Racionaliste të Deklaratës së Pavarësisë, u draftua më 1787-ën, u ratifikua një vit më pas dhe hyri në fuqi të plotë në 1790. Dokumenti u shkrua me dorë nga Xhejms Medisoni i cili ishte prezent në kongres. Ajo përmbante origjinalisht shtatë Artikuj (nene). Tri të parët përcaktojnë ndarjen e pushteteve në: Legjislativ (Kongres Bikameral); Ekzekutiv (Presidenti); Gjyqësori (Gjykata Supreme). Artikujt 4, 5 dhe 6, përcaktojnë përgjegjësitë e shteteve përbërëse në raport me shtetin federal. Artikulli 7 përcakton procedurën e ratifikimit të kësaj kushtetute. Ndër vite, kushtetutës i janë shtuar edhe 27 amendamente (Senati i Shteteve të Bashkuara, 1992).

Kushtetuta u shkrua mbi bazën e *common law* dhe *Magna Carta-s* britanike. Influenca filozofike e kushtetutës vinte prej Xhon Lokut (John Locke), për të përcaktuar juridikisht konceptet e lirisë, jetës dhe të drejtës së pronësisë. Për të përcaktuar ndarjen e pushteteve Monteskejja (Montesquieu) me "Frymën e Ligjeve" kishte influencuar sikurse kemi treguar të gjithë brezin e intelektualëve dhe politikanëve amerikanë. Por edhe intelektualët vendas si Xhon Adamsi dhe Benxhamin Frenklini përmes shkrimeve të tyre në gazeta apo, Aleksandër Hamiltoni dhe Xhejms Medisoni përmes Letrave të tyre Federaliste. Kushtetutës iu shtua një preambul e cila nis me fjalët tepër të famshme: "WE THE PEOPLE ..." (Ne populli), duke treguar kështu bashkimin e kolonive, homogjenitetin politik të popullit dhe barazinë e tyre mes popujve të tjerë sovranë të botës. Ajo vijon me fjalët "...in order to form

a more perfect union” (për të krijuar një union edhe më perfekt), duke treguar se tashmë unioni ekzistonte, dhe se ai duhej perfeksionuar me referencë “Qytetin e shndritshëm në kodër”. Fjalët e tjera kyç të këtyre rreshtave janë: Drejtësi; Qetësi; Mbrojtje; Mirëqenie; Liri; “...për vete dhe për trashëgimtarët tanë”.

10 amendamentet e para të kushtetutës të cilat u ratifikuan në vitin 1991, përbëjnë tërësinë e asaj që njihet prej të gjithëve si “The Bill of Rights” (Karta e të drejtave). Amendamentet e tjera i janë bërë kushtetutës në vitet në vazhdim për të sanksionuar zgjidhje juridike për probleme të ndryshme politike. Amendamentet 1, 2, 3, garantojnë liritë themelore. Amendamentet 4, 5, 6, 7, 8, garantojnë sistemin drejtësinë e sistemit gjyqësor. Amendamentet 9, 10, garantojnë parimin madhor se gjithçka që nuk është e ndaluar me ligj, lejohet. Amendamentet 11, 16, 18, 21, përcaktojnë autoritetin e zgjeruar të qeverisë. Amendamentet 13, 14, 15, 19, 23, 24, 26, garantojnë të drejtat civile. Amendamentet 12, 17, 20, 22, 25, 27, përcaktojnë proceset dhe procedurat qeverisëse.

Legjislativi në SHBA ka si organ përfaqësues Kongresin. Kongresi Amerikan përbëhet nga dy dhoma, Senati dhe Dhoma e përfaqësuesve. Senati përbëhet nga 100 senatorë, nga 2 për secilin shtet. Një e treta e senatorëve zgjidhen çdo dy vite me një mandat prej 6 vjetësh. Senatorët përfaqësojnë interesat e të gjithë banorëve të një shteti (Stevenson, 1989: 35). Dhoma e Përfaqësuesve ka gjithsej 435 anëtarë të cilët zgjidhen çdo dy vjet me një mandat 2 vjeçar. Në ndryshim nga senati, numri i kongresmenëve varion për secilin shtet në proporcion me numrin e popullsisë. Qysh prej fillimit të punës së legjislativit të ri amerikan, që një projektligj të bëhej ligj, ai duhet të votohej në të dy dhomat e kongresit. Ky mekanizëm, mishëron parimin e përfaqësimit sa më të mirë të ideve dhe interesave të popullit. Kësisoj, edhe shtetet që kanë më pak anëtarë në kongres kanë mundësi që ta ngrenë zërin e tyre në senat. Kongresi vendos për taksat, si shpenzohen fondet, si dhe rregullat për dhënien e qytetarisë amerikane. Rregulla të cilat që prej fundit të shekullit të XVIII, janë bërë gjithnjë e më rigorozë.

Presidenti i SHBA është përfaqësues i pushtetit ekzekutiv. Presidenti zgjidhet nga vota popullore me sistemin e kolegjit zgjedhor. Presidenti i parë i 13 kolonive të bashkuara

u zgjodh ai që i kishte udhëhequr ata edhe në luftën për pavarësi, Koloneli Xhorxh Uashington. Kur ai mori detyrën si president në 1789-ën, Kushtetuta ende nuk gëzonte popullaritet, sistemi gjyqësor ende nuk ishte stabilizuar ndaj dhe ligjet nuk kishin si të detyroheshin, ushtria ishte e vogël, dhe flota detare kishte pushuar së funksionuari (QNK, 2010:148). Për shkak se Uashingtoni ishte presidenti i parë ai vendosi precedentët për të gjithë presidentët që do të vinin më pas. Kabineti i presidentit për shembull, i përbërë prej sekretarëve të departamenteve të qeverisë, u nis prej tij si një mënyrë për të marrë vendime të këshilluara. Në fillim ishin vetëm Tomas Xhefersoni (Sekretar i shtetit / Ministër i Punëve të Jashtme) dhe Aleksandër Hamiltoni (Sekretar i thesarit / Ministër i Financave). Në kohën e Linkolnit ishin 4, dhe sot kabineti Obama përbëhet prej 14 sekretarësh. 1789 - 1997 ishte presidenca e tij, duke vendosur kështu një rregull të pashkruar se “presidenti nuk mund të kthehej në një mbret tjetër si ai që kishin shporrur” rregull që u thye vetëm nga F.D. Ruzvelti dhe më pas u sanksionua në amendamentin 22.

Në Letrën e tij të Lamtumirës, Uashingtoni u la një amanet politik amerikanëve. Ai në këtë letër përçoi në tërësi dy mesazhe thelbësore: 1) Amerikanët të mos fokusoheshin shumë tek ndasitë partiake dhe grupimet me interesa të veçanta pasi kjo do ta dëmtonte unitetin e popullit; 2) Amerika të mos krijonte aleanca të përhershme në marrëdhëniet me shtetet e tjera (Washinton, 1797) (një këshillë tipike Realiste ku interesi i shtetit duhet të jetë gjithnjë parësor pavarësisht çdo elementi tjetër) . Këto këshilla pasqyronin edhe boshtin e identitetit politik amerikan. Unitet të brendshëm, dhe përveçim nga të tjerët. Kjo u mishërua prej amerikanëve gjatë gjithë historisë, me përjashtim të Luftës Civile (1861 - 1865).

Një prej detyrimeve kushtetuese të presidentit në kuadër të parimit “Check and Balance” (Kontroll dhe Barazpeshë) të ndarjes së pushteteve, është e drejta e kongresit për t’i kërkuar llogari dhe informacion presidentit në çdo kohë, në lidhje me gjendjen e unionit. Kjo e drejtë, shfrytëzohet sot më shumë publikisht për të bërë politikë, nga sa shfrytëzohej në fillimet e republikës. Nga ana tjetër, edhe fjalimet në publik të presidentit amerikan, janë rritur në shakllë eksponenciale nga Uashingtoni tek Obama (Fiorina, 1998; AmericanRhetoric.com).

Në kushtetutë gjithashtu thuhet se presidenti ka të drejtën e vetos për cilindo ligj. Pasi cilido ligj, edhe pse mund të jetë votuar në të dyja dhomat me shumicë vote, nëse presidenti nuk e aprovon, ai ligj nuk hyn në fuqi. Hartuesit e kushtetutës, për të mos lejuar që (sërish) presidenti të kthehej në një mbret, vendosën një mekanizëm shtesë edhe për këtë rast duke cilësuar se “nëse senati dhe kongresi e rivotojnë ligjin me dy të tretat e votave, atëherë ligji hyn në fuqi”. Administratën publike, ambasadorët dhe zyrtarë të tjerë i emëron presidenti, por marrin shqyrtimin dhe dakordësimin e senatit. Presidenti nuk mund të shpallë luftë apo të nënshkruajë traktate ndërkombëtare përveçse me vendim të kongresit amerikan

Të gjitha këto mekanizma, për funksionimin e qeverisjes, shërbyen si model arketip për të gjithë popujt e botës që më pas aspiruan të bëheshin gjithashtu demokraci. Marrja dhe implementimi i këtij modeli prej shumë shteteve të Europës, e më pas vendeve të tjera të botës, i dha amerikës idenë e udhërrëfyesit të historisë. Amerikanët nisën të ndiheshin se avantgardët e sistemit demokratik. Këtë ndjesi ata e shfaqën shpesh përgjatë historisë.

Gjykata Supreme në Amerikë është institucioni më i lartë përfaqësues i pushtetit gjyqësor. Kjo gjykatë përmes vendimeve të veta përcakton nëse ligjet e dy pushteteve të tjera janë në përputhje apo shkelje me kushtetutën. Kongresi mund të vendosë për numrin e anëtarëve të Gjykatës supreme, por nuk mund të ndryshojë kompetencat e saj, pasi pushteti i saj rrjedhon prej kushtetutës. Gjykatësit e të gjitha niveleve emërohen nga presidenti por miratohen nga senati. Mandati i gjykatësve të Gjykatës supreme është i përjetshëm, ne qëllim që të përjashtohet korrupsioni politik, financiar, apo etik. Vendimet e Gjykatës Supreme nuk mund të apelojnë askund tjetër. Gjykata e lartë sipas kushtetutës ka juridiksion të drejtëpërdrejtë vetëm në dy raste: a) Për rastet e diplomatëve të huaj; b) kur njëra prej palëve është një shtet i Amerikës. Të gjitha rastet e tjera që vijnë në gjykatën e lartë janë apeloime të gjykatave më të ulta. Më qartësisht, ky juridiksion u përcaktua në rastin *Marbury v. Madison*⁹.

⁹ Pwr mw tej, shihni *Marbury v. Madison* <https://www.law.cornell.edu/supremecourt/text/5/137> (parw pwr herw tw fundit mw 18 qershor 2016, 12:00)

Partitë Politike në amerikë, fillimisht u krijuan në mjedisin e trazuar të kohës së revolucionit. Këshilla e parë e Uashingtonit, ajo e mospërçarjes prej partive, u harrua pikërisht në momentin e pasimit të tij. Republikanët (të djathtë) zgjodhën Xhefersonin si kandidatin e tyre, dhe Federalistët (më të majtë ideologjikisht) zgjodhën Xhon Adamsin, ky i fundit, edhe u zgjodh president. Xhefersoni e mori presidencën vetëm pas Adamsit. Kësisoj, u vendos precedenti i garës midis dy partive. Kur kishin kaluar vetëm 50 vite nga revolucionit, amerika do të zgjidhte presidentin e saj të gjashtë. Gjenerali Endrju Xhekson (Andrew Jackson) (1767 - 1845), ishte një hero kombëtar si udhëheqësi i ushtrisë amerikane të pas revolucionit. Pasi ndjeu se ia vodhën zgjedhjet e 1824-ës, ai vendosi të krijonte një parti popullore të vetën të quajtur Partia Demokratike bashkë me presidentin e ardhshëm Martin van Buren (1782 - 1862). Ai kandidoi sërish me partinë e re, kundër presidentit J. Q. Adams i cili përfaqësonte Demokratët Republikanë (Të majtët). Pas presidencës Xhekson, partitë u ridimensionuan duke u përcaktuar edhe ideologjikisht Demokratët (të djathtë) dhe Vigët (të majtë). Më pas vigët u shndërruan në Republikanë të cilët ishin kryesisht pro lirisë dhe kundër skllavërisë. Në një farë mënyre duke mishëruar vizionin e vërtetë religjioz dhe iluminist njëkohësisht. Presidenti i tyre i parë ishte Abraham Linkoln (1809 - 1865). Pas Luftës Civile, për të cilën do të flasim më tej, Demokratët (pro skllavërisë) u përqendruan në shtetet e jugut, ndërsa Republikanët (pro lirisë) në ato të veriut.

Demokratët, thuhet nuk fituan asnjë president deri në zgjedhjen e presidentit Vudrou Uillson (Woodrow Wilson) (1856 - 1930), i cili gjithsesi u zgjodh për shkak se vota e elektoratit Republikan u nda mes Taftit dhe T. Ruzveltit. Parimet republikane të lirisë së tregut dhe prohibicionizmit me bazë religjioze, nuk po e nxirrnin vendin nga depresioni derisa erdhi "The Neë Deal" (marrëveshja e re) e F.D. Ruzveltit e cila do të përcaktonte një kurs të ri për amerikën. Si një platformë e majtë, Marrëveshja e Re e ktheu shtetin në furnizuesin kryesor për qytetarët.

Kjo platformë i kaloi grupimet e votuesve të shtresave të ulta, zezakët, emigrantët dhe katolikët nga partia Republikane, tek partia Demokratike. Kur në vitin 1960 presidenti demokrat L.B. Xhonson përkrahu Lëvizjen e të Drejtave Civile të zezakëve, dhe me

presidentin Nikson i cili si republikan ishte më regresiv për sa i takonte racizmit, demokratët i humbën pak nga pak shtetet e jugut që kaluan si elektorat në favor të Republikanëve të cilët gjithashtu fituan edhe votat e shteteve të amerikës qendrore.

Demokratët e sotëm mendojnë se duhet rritur aktiviteti shtetëror për t'iu shërbyer më shumë njerëzve edhe nëse kjo e dëmton biznesin. Ata fokusohen tek nxjerrja e sa më shumë ligjeve dhe rregullimeve. Republikanët e sotëm besojnë se shteti duhet t'i qendrojë larg jetës së njerëzve dhe marrëdhënieve të tyre, sa më pak rregulla për biznesin, sa më shumë fuqi për ushtrinë dhe përqendrohen tek mbrojtja me fanatizëm e kushtetutës. Në përmbyllje të këtij pasqyrimi, mund të përdorim fjalën e Lordit Brys (Bryce) i cili në 1889-ën vëzhgonte: *“Në Amerikë, forcat që shkaktojnë lëvizjet e mëdha, janë partitë. Qeveria ka më pak fuqi sesa në Europë, partitë kanë më tepër”* (Bryce, 1910:5).

3. Aspekti socio - kulturor i popullit amerikan

Kultura amerikane përfshin traditën dhe normat shoqërore të Shteteve të Bashkuara. Sikurse e përkufizon antropologia Cristina De Rossi (Barnet and Southgate College, Londër) “Kultura përfshin praktikat fetare, ushqimin, veshjen, gjuhën, martesën, muzikën, mënyrën e gjykimit, përshëndetjet, dashurinë për të afërmit, dhe ndonjë milionë gjara të tjera”. Shtetet e Bashkuara të amerikës është një prej vendeve me diversitetin kulturor më të madh në botë, e sidoqoftë identiteti i tyre parëso është amerikanizmi: i përveçëm, besimtar dhe racionalist.

Në mesin e shekullit të tetëmbëdhjetë, kolonitë amerikane kishin arritur një stad pjekurie dhe kulture që ishte tradicionale dhe origjinale, thënë këtë, autentike (Maldwyn, 1993:27). Idetë angleze, gjuha angleze dhe popullsia me prejardhje nga Anglia ishte shumicë kudo. Ende nuk ekzistonte ndonjë ekspresivitet i madh në letërsi, në arte ose në arkitekturë. Në krahasim me anglezët, amerikanët e parë kishin më shumë vetbesim dhe iniciativë, ishin më lehtë të lëvizshëm nëpër koloni dhe ishin më shpejt të adaptueshëm. Me kalimin e brezave të parë, kulturalisht ata nuk po ndiheshin më anglezë, irlandezë, gjermanë apo tjetër. Ata nisën të ndiheshin amerikanë jo vetëm në aspektin gjeografik të fjalës. Për shkak të demografisë së pakët amerikanët nisën që t’i forconin marrëdhëniet familjare edhe më shumë sesa europianët. Nga ana tjetër, në krahasim me europianët ata nisën ta zbehnin autoritetin prindëror. Për shkak të lehtësisë së madhe për të fituar tokën si pronë, të rinjtë ishin shumë të nxitur që të pushtonin perëndimin (si ilustrim konkret vizual mund të shërbejë filmi “How the West Was Won”), dhe kësaj, edhe në aspektin antropologjik, ndërhyrjet e prindërve në martesë nisën të kishin gjithnjë e më pak vend. Kjo e fundit erdhi edhe për shkak se tanimë brezat nuk kishin më frikë prej heqjes së trashëgimisë (Maldwyn, 1993:28). Pra një faktor me rëndësi ishte veç demografisë, edhe gjeografia.

Si konglomerat kulturash, kultura e sotshme popullore amerikane ka në bosht anglo-saksonizmin e ngulitësve të parë, por është influencuar mjaft prej kulturës së largët të indianëve vendas, prej kulturës së latino-amerikanëve, prej kulturës së afrikanëve që e populluan kontinentin po aq herët sa edhe ngulitësit, prej kulturës aziatike, por edhe prej

pjesës tjetër të botës. Sot shumë komunitete kulturore brenda kulturës amerikane, e ruajnë shpesh gjuhën e tyre origjinale apo edhe traditat fetare e familjare, mirëpo mënyra e tyre e jetesës është totalisht e integruar në homogjenitetin e frymës së përgjithshme (De Rossi, 2015). Stili amerikan i veshjes, shpesh dallohet me të parë, për shkak edhe të përdorimit të veshjeve tipike në sferën audiovizuale si filma, video muzikore, fotografi, postera, reklama, etj. Xhinset, atletet, kapelet sportive të bejsbollit, apo çizmet e kapelet *cowboy*, njihen ndërkombëtarisht si amerikanizma.

Ndërkombëtarisht ka edhe një gamë ushqimesh që njihen si amerikane. Për shembull hamburgeri, hot-dogu, patatinat, makarona me djathë, apo byrek me mollë. Sidoqoftë, kuzhina amerikane, që është shumë më e plotë sesa kaq, është influencuar thellësisht përmes komuniteteve emigrante prej kuzhinës italiane, meksikane, indiane, apo aziatike. Amerika është sot e njohur gjithashtu edhe si një lider në prdukcionet mediatike. Mund të thuhet me bindje se ata e kanë kthyer median në shkencë. Sipas Departamentit Amerikan të Tregtisë, ata sot prodhojnë një të tretën e produkteve mediatike të botës (Selectusa.gov). Industria televizive në amerikë i pati fillesat e veta në vitet '50. Amerika ka ndërtuar edhe një industri tejet dinamike për prodhimin e filmit me qendër në Hollivud, Kaliforni. Fakti është që sot, filmat dhe serialet amerikane transmetohen dhe influencojnë gjithë botën (sikurse do të vërtetojmë më tej).

Në amerikë, festat tradicionale nisnin që nga më e rëndësishmja, 4 korriku, dita e pavarësisë. *Memorial Day* (Dita e Përkujtimit) e barazvlefshme me atë që shumë vende të tjera e quajnë dita e dëshmorëve të atdheut, në Amerikë festohet të hënën e fundit të çdo maji. Festa e Punës në të hënën e parë të çdo shtatori. *Thanksgiving* (Dita e falënderimeve) festohet të enjten e katërt të nëntorit dhe ka si referencë periudhën koloniale, kur emigrantët e Mayflower-it, mbërritën shëndoshë e mirë në Massachusetts, por festohet njëkohësisht edhe bollëku i të korrave dhe pjelloria e tokës. Dita e presidentëve festohet të hënën e tretë

të shkurtit dhe ka si referencë ditëlindjen e Uashingtonit dhe Linkolnit. Të drejtat civile festohen të hënën e tretë të janarit¹⁰.

¹⁰ 101 karakteristikat e amerikanëve, University of Michigan <https://www.press.umich.edu/pdf/9780472033041-101AmerCult.pdf> (parw pwr herw tw fundit mw 18 qershor 2016, 15:20.)

KAPITULLI IV: KRIJIMI I IDENTITETIT POLITIK AMERIKAN

1. Krijimi i identitetit popullor

Parashtrimi i thelluar në pjesën e dytë të kapitullit të dytë, pasi na ka dhënë mundësinë të kuptojmë ngjarjet dhe fenomenet që e krijuan identitetin amerikan, na ndihmojnë që ta vëzhgojmë më thjeshtë edhe zhvillimin e këtij identiteti në histori, dhe cilat ishin elementet që më së shumti e influencuan atë. Për Aleksis de Tokëvil (Alexis de Toqueville) (1805 - 1859), autorin e veprës klasike “De la démocratie en Amérique ” (Mbi demokracinë në Amerikë) (1835/1840), karakteristika më tipike e amerikanëve ishte “barazia e kushteve”. Në këtë vëzhgim të tijin, Tokëvil gjithashtu vëren mungesën e barrierave sociale dhe të rangjeve. Kjo barazi kushtesh për të, nuk vinte vetëm prej sistemit por edhe prej vetë njerëzve të cilët dukej sikur i përkisnin të gjithë shtresës së mesme dhe kishte shumë pak tejet të varfër, ose tejet të pasur.

Titujt ishin thuajse tabu, dhe njerëzit mirësilleshin ndaj njëri - tjetrit përmes titullit të profesionit të tyre, si përshembull i nderuar avokat, i nderuar doktor, zoti senator, zoti tregtar, etj. Megjithëse në qytetet e mëdha si Bostoni, Filadelfia apo Nju Jorku kishin nisur të grumbulloheshin një elitë njerëzish shumë të pasur, mënyra e të folurit, e të veshurit, apo sjellja e tyre ishte e ngjashme në të gjitha shtresat dhe në të gjitha qytetet (Maldwyn, 1993:124).

Për një periudhë të madhe kohe, amerikanët nuk krijuan dot në identitetin e tyre popullor aspektin artistik muzikor, arkitekturor, teatral apo letrar. “Në të katër cepat e botës, tregomëni dikë që lexon një libër amerikan, mundeni? Apo që shkon të shohë një pjesë teatrale amerikane? Apo që të admirojë një pikturë a një skulpturë amerikane?” Këto pyetje retorike të reverendit Sidnej Smith të botuara në Edinburgh Review, 1820, i inatosën shumë amerikanët. Mirëpo përtej cinizmit, kjo ishte e vërteta. Pas tre ose katër dekadash prej kësaj kritike, amerikanët nisën të shfaqnin identitet të tyre edhe aty ku i ngacmonte reverendi

Smith. Në pikturë u shquan si peizazhistë Asher Durand, George Bingham dhe në skulpturë Hiram Powers. Muzika amerikane folk dhe country u zhvilluan aq sa më pas do të shijoheshin edhe prej kontinentit të vjetër, e sidomos himnet e krishtera. Në letërsi Washington Irving, James Fenimore Cooper, por duhet përmendur sidomos edhe Edgar Allan Poe. Më vonë erdhën edhe figura të mëdha si Ralph Waldo Emerson dhe Henry David Thoreau, Nathaniel Hawthorne, Herman Melville, Walter Whitman esidomos Mark Twain.

Ndikimi i madh letrar në identitetin popullor amerikan erdhi për disa arsye që sqarohen më së miri në veprën “Komunitete Imagjinare” të Benedikt Andersonit. Por duhet të veçojmë një element për të treguar se si romani influencon (Anderson, 2013:44):

“...këtu [në roman] ne shohim “imagjinimin kombëtar” në zhvendosjet e një heroit vetmitar përmes një horizonti sociologjik të palëvizshëm që e shkrin botën brenda romanit, me botën jashtë. Ky tour d’horison aventurash: burgje, spitale, fshatra të thella, manastire, indianë, zezakë, është gati – gati një tour de monde. [...] Asgjë nuk na siguron më shumë për këtë soliditet (social) sesa vargu i shumësive. Shumësitë na mbjellin idenë e një hapësire të përbashkët sociale homogjene plot me (objekte) burgje të krahasueshme”.

Pikërisht kjo shkrirje mes trillimit dhe njëmendësisë na tregon fuqinë e vërtetë të romanit, për të projektuar tek lexuesi një identitet të caktuar përmes projektimit të vetes tek heroit i historisë. Sidoqoftë, ky element nuk është vetëm karakteristik për formimin e identitetit popullor amerikan, por po aq thelbësor edhe për të gjitha lëvizjet nacionaliste¹¹.

Sot, krijimet kulturore amerikane janë të shtrira në çdo fuhë. Me një ndikim ndërkombëtar mbizotërues dhe me një vetëbesim të madh. Dinamika e sotme na shfaq një ndërkëmbim të vazhdueshëm mes identitetit tashmë të formësuar amerikan dhe kulturës së sotme amerikane. Një herë identiteti projektohet përmes kulutrës, e një herë kultura e ndikon identitetin. Nëse do t’i përgjigjeshim pas njëqind vjetësh reverendit Smith, do të mund t’i paraqisnim me qindra raste. E nëse do t’i përgjigjeshim sot, dyqind vite më pas, do t’i paraqisnim me miliona evidenca të ndikimit kulturor amerikan në të gjithë botën.

¹¹ 11 Pwr mw tepwr shihni Eric Hobsba32m “Shpikja e traditws”, Pika pa Sipwrfaqe, Tiranw 2014.

Nga Lufta Civile e deri në Luftën e Parë Botërore, identiteti popullor amerikan, ishte i tensionuar. Nga njëra anë ishin mbetjet e fundit të vendeve të origjinës që ishin sjellë prej emigrantëve, e nga ana tjetër ishte shtysa kulturore e letrare që i nxiste amerikanët të shijonin përveçësinë e tyre. Shumë shpejt, arkitektura dhe urbanistika amerikane, do të shërbenin si arketip jo vetëm dallues për amerikanët, por edhe për qytete e vende të tjera që donin të merrnin borxh modelin amerikan. Përqendrimi i madh i zyrave në ndërtesat e qendrave të qytetit, i nxiti arkitektët amerikanë që të përdornin artisticitetin dhe gjeninë inxhinierike për të krijuar një formë arkitektonike tipike për kulturën amerikane: qiellgërvishtësen (skyscraper). Arsyeja praktike e zhvillimit të qiellgërvishtëseve ishte kostoja e lartë e truallit ë bënte të detyrueshëm shfrytëzimin e ajrit. Strukturat ishin prej çeliku, në mënyrë që të lironin muret prej peshës. Futja në përdorim e ashensorëve elektrikë në masë, bëri të mundur ndërtesa qiellgërvishtëse edhe më të larta. Ky imazh u zhvillua aq shumë sa që më 11 shtator 2001, për të sulmuar pikërisht amerikanizmin, u goditën me një sulm terrorist me avionë vetvrasës dy qiellgërvishtëset e Nju Jorkut, të njohura si Kullat Binjake.

Për të mbështetur atë që kemi shkruar derimë tani, do të shkëpusim prej veprës *Amerika* (1986) të Zhan Bodriar (Jean Baudrillard) 1929 – 2007, një pjesë nga kapitulli që ai e quan “*Utopia e realizuar*”:

“Për europianin, edhe sot, Amerika përfaqëson një lloj arratie, një fantazi emigrimi e për rrjedhojë një mënyrë brendësimi për kulturën e tij ose të saj. [...] Themeli i ndërtimit të Amerikës shërben si një përgjigje për këtë ndërveprim dual midis thellësimit të ligjit moral në ndërgjegje individuale, një radikalizim kësisoj i kushtit të utopisë që shpesh e shfaqin sektet, dhe materializimit të kësaj utopie në punë, zakone dhe në mënyrën e jetesës. Të vish sot në amerikë, do të thotë të dëshmosh atë “religjion” që amerikanët kanë si mënyrë jetese, për të cilën flet edhe Tokëvili. Utopia materiale e mënyrës së jetesës, ku suktesi dhe veprimi shihen si ilustrime të thella të ligjit moral u kristalizua prej emigrimit. [...] Amerika është

versioni fillestar i modernitetit. Ne (Europa) jemi versioni i dubluar ose i titruar i saj.

Momenti që e katapultoi identitetin amerikan nga epoka moderne drejt asaj postmoderne, ishte Revolucioni Seksual (1960 – 1980). Revolucioni seksual që nisi në vitet '60, apo siç njihet ndryshe edhe si periudha për çlirim seksual ishte një lëvizje antikonformiste e cila sfidonte kodet e sjelljes shoqërore lidhur me seksualitetin dhe me marrëdhëniet ndërpersonale në botën perëndimore në dekadat '60, '70, '80 (Allyn, 2000). Çlirimi seksual nënkuptonte pranimin e marrëdhënieve seksuale jo-heteroseksuale; pranimin e marrëdhënieve seksuale paramartesore; pranimin e alternativave ndaj monogamisë; pranimin e bashkëjetesës, të këmbimit të partnerëve, apo të marrëdhënieve intime vetëm për një natë (Escoffier, 2003).

Arsyeja se pse revolucioni seksual lindi, mund të shihet edhe si një proces i gjatë i shkrimtarëve D.H. Lawrence, Wilhelm Reich, apo edhe keqkuptimit të psikanalizës frojdiane, mirëpo shpërthimi në amerikën e lodhur nga zyrtësia e papërballueshme shoqërore e pas Luftës së Dytë Botërore si dhe nga Lufta në Vietnam, erdhi për të shpërfaqur bindjen e brezit të ri, se erotizmi duhet ngritur lart si një element i jashtëzakonshëm i jetës, dhe nuk duhet shtypur më nga familja, moraliteti, feja dhe shteti (Isseman, 2012:138-140).

Pasojat që ky revolucion solli, ishte shkatërrimi i idealeve fetare por edhe iluministe (racionaliste) të brezit të ri amerikan. Tanimë, amerikanët nuk do të punonin më të bashkuar për të ndërtuar “Qytetin e Shndritshëm në Kodër”, por secili do të luftonte për vete, për të bërë sa më shumë para, famë dhe sukses; për ta shijuar jetën si të dëshironte, pa komplekse, dhe pa paragjykimë. Pasojat morale të këtij revolucioni, i vuan njerëzimi edhe sot.

2. Krijimi i identitetit politik përmes ligjërimit

Shpesh amerikanët konsiderohen si një prej popujve më të influencueshëm përmes fjalimeve politike. Mirëpo nëse vëzhgojmë sjelljen e amerikës në marrëdhëniet ndërkombëtare, do të vërejmë se ata gjithashtu janë shteti më influencues përmes ligjërimit. Shpesh hartohen lista me 10, 50, apo 100 fjalimet më influencuese për amerikanët. Këto lista nuk janë spekulime, mirëpo rezultat i matjeve studimore që ata zhvillojnë mbi veten. Më poshtë do të shkëpusim për të analizuar disa prej këtyre fjalimeve në momentet kyç të historisë amerikane.

Përgjatë historisë së tyre, amerikanët kanë prodhuar një tërësi fjalimesh, shkrimesh, librash dhe deklaratash, të cilat përbëjnë trashëgiminë politike të amerikës, por edhe na japin mundësinë të futemi në lëkurën e dëshmitarëve okularë që e kanë përjetuar atë kohë. Përmes këtyre shkrimeve e fjalimeve, amerikanët kanë bërë thirrje për bashkësim; kanë protestuar ndaj padrejtësive, kanë argumentuar veprime ose mosveprime; apo i kanë nxitur njerëzit që të jetojnë me idealet e pastra të përbashkëta. Në këto shkrime e fjalime do të vëmë re se pavarësisht se i drejtohen një audience laike dhe hapësirës publike, baza e tyre rrjedhon prej shkrimeve të shenjta. Në këtë tërësi do të mund të gjesh dukshëm forcën e shpirtit amerikan.

Xhon Uintrop (John Winthrop) – **A model of Christian Charity, 1630** (Një model për mëshirën e krishterë) (http://ëinthropsociety.com/doc_charity.php). Duke u bërë gati për udhëtimin e tyre të gjatë, puritanët mirëpritën fjalët e liderit të tyre Xhon Uintorp i cili ishte një jurist dhe jo një pastor. Megjithëkëtë, Uintorpi mbajti një fjalim që sot konsiderohet ende si një prej predikimeve më të mëdha në Amerikë. Ky fjalim u bazua mbi idenë se puritanët janë njerëz që kanë një marrëveshje të veçantë me Zotin: nëse ata i binden ligjeve të zotit, atëherë do ta kenë përmbushur detyrën e tyre, dhe do të kenë fituar mbrojtjen nga Zoti. Uintorpi u bën thirrje puritanëve që të krijojnë një shembëllim të “Qytetit të Shndritshëm në Kodër”, një shoqëri të cilën Zoti ta dojë, e kjo të shërbejë si një model të cilin një ditë të mund ta përftojë dhe aplikojë e gjithë Europa. Kjo metaforë e Uintorpit, ka rezonuar përgjatë gjithë historisë amerikane.

Tomas Xheferson – Deklarata e Pavarësisë, 1776.

(<http://ëëë.archives.gov/exhibits/charters/declaration.html>). Deklarata sikurse kemi analizuar më sipër u shkrua me shumë pasion prej Xhefersonit i cili me një bindje të thellë për lirinë, liston disa prej abuzimeve të mbretit. Kjo analizë e tij e shkruajtur si poezi shtron themelet për justifikimin e vendimit të 13 kolonive. Përgjatë deklaratës Xhefersoni i referohet fuqisë Hyjnore me fjalë që mund të kuptohen nga i gjithë populli. Si përshembull “Zoti i natyrës”, “ligjet e natyrës”, “Krijuesi”, “Providenca” spo “Gjykatësi Suprem i Botës”. Xhefersoni ishte një iluminist lokjan e hjumjan më shumë sesa një i krishterë i devotshëm, por ai besonte se vullneti i zotit ishte shpalosur në natyrë përfshirë edhe natyrën njerëzore. Prandaj përmes deklaratës së pavarësisë ai i siguron lexuesit se vullneti i Zotit manifestohet edhe përmes veprimeve të amerikanëve.

Pasi Amerika shpalli pavarësinë dhe nisi jetën e vet politike si shtet-komb, elita drejtuese shihte para vetes një mal të madh me detyra për të zbatuar dhe me çështje të përditshmërisë për të zgjidhur. Gjatë presidencës së Xhefersonit, presidentit të tretë të SHBA-ve, lindi nevoja për sqarimin e dilemës së marrëdhënies së shtetit me kishën. Filozofia e kësaj marrëdhënieje që e shoqëroi gjithë historinë politike amerikane, mund të lexohet në, e ndër rreshtat e letrës që Xhefersoni si president i kthen famullisë baptiste të Denburit. **Letra për Baptistët e Denburit, 1802**, përmban në kulmin e vet metaforën e famshme të “murit ndarës” (<https://ëëë.loc.gov/loc/lcib/9806/danpre.html>). Në vetëm 18 rreshta të shkruara me dorë, Xhefersoni e falënderon Shoqatën Baptiste të Denburit dhe përfaqësuesit e saj të cilët të shqetësuar për liritë fetare i kishin drejtuar atij një letër ku e shprehnin këtë shqetësim. Në përgjigje, Xhefersoni president, u rikujton atyre Amendamentin e Parë të kushtetutës. Duke e ditur se kjo letër do të publikohej e do të përhapej, presidenti dëshironte t’i rikujtonte të gjithë për këtë parim. Se ndryshe nga ç’ kishte qenë historia europiane e mijëvjeçarit të fundit, në amerikë, kisha dhe shteti do të bashkëjetonin me një “mur ndarës”. Sidoqoftë, edhe pse i ndau institucionet si të pavarura ai e shihte takimin e tyre në hapësirën publike.

Ralf Ualdo Emerson (Ralph Waldo Emerson) gjithashtu ka mbajtur një fjalim historik të quajtur **Fjalimi i Shkollës Divinity, 1838**. Në fjalimin që mbajti përpara të diplomuarve të Harvardit të atij viti, (<http://ëëë.emersoncentral.com/divaddr.htm>) Emerson bëri zhurmë. Ai për herë të parë në amerikë arriti të kthente vëmendjen tek problemet e krishtërimin, edhe pse Luteri kishte tri më se tri shekuj që e kishte nxitur reformën. *“Krishtërimi historik ka rënë në gabimin që korrupton cilëndo mundësi për ta komunikuar fenë. Ajo që na shfaqet ne sot dhe që na është shfaqur përgjatë shekujve, nuk është doktrina e shpirtit, por një ekzagjerim i personales, pozitives dhe ritualit. Sidomos me ekzagjerime për personin e Krishtit”*. Duke e injoruar dogmën, Emerson e fton audiencën e tij që të besojnë mirëpo duke kërkuar përndritjen. Komentet e tij në këtë fjalim krijuan një flakanajë të përgjithshme aq sa për të mos e ftuar më në Harvard për rreth 30 vite (Elton, 1939:41-45).

Domethënia e 4 korrikut për zezakun, 1852, nga Frederik Daglas (Frederick Douglass) (<http://ëëë.pbs.org/ëgbh/aia/part4/4h2927t.html>) është një fjalim që aktivisti abolicionist zezak e mbajti në Ditën e Pavarësisë në vendlindjen e tij Rochester Nju Jork. Daglasi ishte një skllav i arratisur i cili në fjalimin e tij bën kontrastin midis pavarësisë së amerikanëve dhe skllavërisë së zezakëve nën amerikanët. Në fjalim, ai dënon ashpër të gjitha vuajtjet dhe dëmet që u shkakton skllavëria jetëve të zezakëve. Ai u thotë amerikanëve se skllavëria që ata strehojnë, është një mëkat kombëtar, e se amerikanët janë hipokritë e bëjnë sakrilegj që e tolerojnë. Si një profet i Izraelit të lashtë, Daglasi parathotë se Shtetet e Bashkuara do të kenë të njëjtin fund si Babilonia, *“të shkatërrohen prej zemërimit të Zotit”*.

Vetëm pak vite më pas, amerikanët zgjodhën për president, një prej njerëzve më të mençur, fjalëtarëve më të talentuar, dhe presidentëve më të dashur të të gjitha kohërave, Abraham Linkolnin. Jeta, vepra dhe fjalimet e Linkolnit, studiohen nëpër botë, sidomos për impaktin në historinë dhe politikën e Amerikës. Për llogari të këtij punimi do të marrim shkurtimisht në shqyrtim dy fjalime që formësuan identitetin politik të amerikanëve, **Fjalimin në Gettysburg, 1863**, dhe **Fjalimin e Mandatit të Dytë, 1865**. (respektivisht <http://ëëë.abrahamlincolnonline.org/lincoln/speeches/gettysburg.htm> dhe

<http://www.ourdocuments.gov/doc.php?flash=old&doc=38>). Në Getisburg, Linkolni foli për luftën vëllazërore mes kolonive të veriut dhe atyre të jugut lidhur me çështjen e skllavërisë, për arsye ekonomike dhe ideologjike. Në këtë fjalim, ai gdhendi fjalinë më të famshme lidhur me demokracinë, se demokracia është *“Qeverisja e popullit prej popullit, për popullin”*. Ky fjalim me vetëm 272 fjalë që zgjati vetëm 2 minuta, bëri të mundur që populli të rikujtonte se pse në fakt ishte themeluar Amerika, dhe sesi historia amerikane kishte një domethënie, atë se *“të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë”* sikurse thoshte edhe deklarata e tyre e pavarësisë. (Cottrol, 2013).

Në fjalimin e mandatit të dytë, Linkolni u shfaq si një prej presidentëve më shpirtëror të historisë amerikane. Teksa ai u ngrit të fliste, një valë e madhe dhe e gjatë duartrokitjesh e pushtoi gjithë sheshin e Kapitolit në Uashington D.C. në një turmë që nuk ishte stepur nga shirat e mëdha të asaj jave (White, 2002). Sapo duartrokitja po venitej, e Linkolni po bëhej gati të fliste, retë u hapën dhe dielli shkëlqeu mbi shesh, sikurse raportonte gazetari Noah Brooks. Linkolni foli për reflektimet e veta thellësisht teologjike mbi Luftën Civile që sapo ishte kapërcyer. Aty Linkolni shprehu mendimet e veta mbi providencën e Zotit, mbi vullnetin e Tij, mbi ngjarjet që Ai kontrollonte dhe mbi ndëshkimet e Tij për mëkatet e fatit njerëzor. Në vend të një fjalimi që do të shfaqte lavdinë e fitores së zgjedhjeve e ca më shumë atë të fitores së luftës, Linkolni mbajti një fjalim ku i ftonte bashkëqytetarët e tij që të bashkëpunonin për paqen dhe për mëshirë reciproke. Ai bëri thirrje që njerëzit ta falnin njëri – tjetrin e të pajtoheshin e të shëronin plagët. Prej atij momenti, Amerika mori rrugën e rindërtimit.

Një shekull më pas, presidentët F.D. Ruzvelt, Duajt Ajzenauer dhe J.F. Kenedi, gjithashtu ndikuan përmes fjalimeve të tyre duke shkruar në memorien e shpirtit amerikan fjalitë reciproke si: *“E vetmja gjë prej së cilës duhet të kemi frikë, është vetë frika”*; Shtojca e fjalëve *“Under God”* (nën një Zot), në Betimin e Flamurit; dhe rikujtesa e *“Murit Ndarës”* në fjalinë *“Unë besoj në një Amerikë ku ndarja mes kishës dhe shtetit është absolute”* nga Kenedi.

Në vitin e vrasjes së presidentit Kenedi, dy zëra të fuqishëm të lëvizjes për të drejtat civile të zezakëve, Martin Luter King Jr. Dhe Malkolm X, të dy të burgosur në burgje të ndryshme, shkruajnë letra e fjalime të fuqishme për të frymëzuar lëvizjen. I pari si një pastor protestant, e i dyti si një Musliman i konvertuar. Në të famshmen **Letër nga Burgu i Birminghamit**, MLK i kthen përgjigje një grupi pastorësh që e kritikonin për protestat e tij të padhunshme dhe i sugjeronin me ngulm që të priste deri sa të vinte koha kur segregimi do të shkulej në mënyrë të ligjshme. Teksa e akuzonin si ekstremist, ai u përgjigjet atyre me pyetjet retorike: A nuk ishte Jezusi ekstremist në dashuri? A nuk ishte Amosi një ekstremist në drejtësi? A nuk ishte Pali një ekstremist për ungjillëzimin? Dr. King gjithashtu kritikon në këtë letër edhe godinat shumë luksoze të shumë kishave në amerikë ndërkohë që gjendja ekonomike e zezakëve ishte në kontrast të plotë me këtë bollëk.

Malkolm X nga ana tjetër bënte thirrje për një sistem ekonomik autonom për zezakët, për bashkimin e tyre të fuqishëm, dhe dënonte mëkatet e të bardhëve ndaj zezakëve. Shpesh Malkolm X i referohej historisë së skllavërisë së popullit të zgjedhur në Egjipt, në analogji me popullin zezak dhe vuajtjet e tij në amerikë.

Në vitin 1983, teksa i adresoj Shoqatës Kombëtare Evangjelike, presidenti Ronald Regan e cilëson Bashkimin Sovjetik si **“Perandoria Djallëzore”**. Megjithëse shumica e fjalimit përqendrohet tek roli i fesë dhe moralit në jetën publike, ky etiketim që bëri xhiron e medias botërore, u rikujtoi amerikanëve rolin e tyre si misionarë shpëtimtarë, e në këtë rast duke e përfytyruar amerikën si një fanar shprese për kombet e tjera të botës. Duke iu referuar Librit të Zbulesës, presidenti Regan bën një analogji me luftën apokaliptike të së mirës ndaj së keqes. Ky fjalim ishte praktikisht themeli i dukshëm i projektimit të amerikës si shpëtimtare në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Të njejtën retorikë të luftës të së mirës ndaj së keqes e ripërdori presidentit Xhorxh W. Bush Jr. Në **Fjalimin e Gjendjes së Unionit, 2002**, presidenti i përshkroi shtetet që strehonin terroristë si shtetet e **“Boshtit Djallëzor”** (The Axis of Evil). Në këtë bosht,

presidenti vendosi Iranin, Irakun, dhe Korenë e Veriut të cilat prodhonin, shisin dhe shkëmbejnë mjete ose armë për shkatërrimin në masë, biologjike ose bërthamore. Ky fjalim, justifikoi ndërhyrjet ushtarake në Afganistan (që kishte ndodhur), dhe në Irak (që do të ndodhte pas një viti).

Në këtë kolazh fjalimesh do të përfshijmë një tjetër influencues të madh. Ai është presidenti i 44-t i SHBA, Barak Obama. Në dy raste Obama ia ka dalë të impaktojë mbi identitetin politik amerikan. Fillimisht me fjalimin e tij të vitit 2006 kur shërbente si senator në senatin e shtetit të Illinoit. Më pas si presidenti i sapoardhur në detyrë i Amerikës, në Universitetin e Kajros, 2009. Fjalimet **“Thirrje për përtëritje”** dhe **“Një fillim i ri”** arritën respektivisht të ndiknin në jetën politike të amerikës dhe të botës. Në fjalimin e 2006-ës, (https://www.youtube.com/watch?v=pCZOyGIKp_E) Obama e nisi duke konfirmuar sesa popull besimtar janë amerikanët, e më pas tërhoqi vëmendje duke e vendosur historinë e jetës së tij në qendër. Kjo mundësoi që audiencia dhe më pas të gjithë lexuesit e fjalimit, ta asocionin Obaman me historinë e amerikës përmes fjalëve kyç: emigrant, afrikano-amerikan, presbiterian, Harvard, shpresë, etj. Në këtë fjalim ai kritikon laikët dhe ateistët për sulmin që u bëjnë besimtarëve, dhe kujton se Linkoln, Daglas apo Doroti Dei, ishin reformatorë shumë besimtarë, dhe vetëm përmes argumenteve fetare arritën që t'i argumentonin kauzat e tyre për liri dhe çlirim. Ai evokoi edhe një herë temën e madhe të Xhefersonit për **“Murin Ndarës”**, si dhe theksoi se tashmë Amerika nuk ishte më një komb i të krishterëve, por edhe i muslimanëve, i çifutëve, i hinduve dhe i jobesimtarëve gjithashtu.

Në fjalimin e 2009-ës, (https://www.youtube.com/watch?v=B_889oBKkNU) Obama e nis duke përshkruar marrëdhëniet e përbashkëta mes botës islame dhe perëndimit. Ai bën thirrje për mirëkuptim reciprok dhe bashkëpunim për të zhbërë ekstremizmin e dhunshëm. Ai citon menjëherë kuranin duke thënë **“Ji i ndërgjegjshëm për Zotin, dhe fol gjithnjë të vërtetën”** (BBC: Reynolds, 2009). Për sa i takonte Irakut, Obama theksoi se Amerika, duhet të provojë të forcojë diplomacinë e saj dhe jo ushtrinë, në mënyrë që problemet dhe konfliktet të mund të zgjidhen pa luftë. Në këtë fjalim ai ishte presidenti i parë që pranoi

ndërhyrjen amerikane në grushtin e shtetit në Iran në 1953-shin. Ndryshe nga sa ishte lënë të kuptohej prej paraardhësve të tij, Obama shpall se “Amerika nuk hamendëson se e di çka është më e mira për këdo”.

Ky varg analizash është ngritur mbi fjalime të cilat kanë të përbashkët jo vetëm impaktin e këtyre fjalëve në jetën politike në amerikë, por gjithashtu edhe në identitetin e amerikanit si individ politik. Nëse i rilexojmë me vëmendje, këto fjalime e formësojnë identitetin politik të amerikanit, duke u mbështetur mbi bazën e predikimeve të shkrimeve të shenjta dhe nevojën për harmonizimin mes religjionit dhe politikës në hapësirën publike. Kësisoj, mund të kuptojmë se sa i fuqishëm është ndikimi i shkrimeve të shenjta në kulturën dhe organizimin socio-politik të amerikanëve. Mund të kuptojmë gjithashtu se sa ndikim kanë në politikë, tradita fetare mbi të cilën është ngritur e gjithë jeta politike përgjatë historisë së popullit amerikan.

3. Projektimi në marrëdhëniet ndërkombëtare

Përveçësia (Exceptionalism) amerikane nënkupton një imazh të caktuar të rolit të Amerikës në botë që është rritur për shkak të një eksperience të veçantë historike dhe vazhdon të jetë shembulli duke qënë boshti qendror i një sërë vlerash dhe besimesh të lidhura bashke që mund të përshkruhet si një ideologji. Një përkufizim i mirë që mund të përdoret këtu do të huazohet nga Robert G. Patman, që e përcaktoi përveçësinë amerikane si "...një ideologji informale që i pajis amerikanët me një besim të thellë në veçantinë, pandryshueshmërinë dhe superioritetin e parimeve themeluese të kombit dhe gjithashtu me bindjen se "SHBA ka një fat të veçantë ndër kombe" (Patman, 2007:964).

Ky fat i veçantë është perceptuar nga presidentë amerikanë të njëpasnjëshëm si një përgjegjësi për të përhapur konceptet amerikane të lirisë dhe demokracisë në pjesë të tjera të botës që konsiderohen si "të pacivilizuara" ose "të egra" (Bender, 2006:182). Për më tepër, këta presidentë vazhdimisht i janë referuar misionit të Amerikës në terma moralë si beteja "e së mirës kundër së keqes", dhe i kanë supozuar si mirëdashëse perceptimet e të tjerëve.

Nëse ne do të kuptojmë plotësisht Kredon Amerikane (American Creed – Koncepti i barazisë së mundësive përpara ligjit) duhet të fillojmë me "lirinë". Edhe pse, siç argumentohet më sipër, sistemi amerikan i vlerave nuk mund të vlerësohet plotësisht pa marrë në konsideratë të gjithë sistemin e vlerave si të tërë, mund të thuhet se liria është një koncept aq qendror për të sa qëndron në themel të ideologjisë amerikane. Foley, me kujdes dhe elokuencë shpjegon rëndësinë e saj si vlerë:

"Koncepti i lirisë qëndron në zemër të identitetit amerikan. Njëherazi, ai është një pikë reference kulturore dhe etike themeltare, një ideal përkufizues, një precept kontrolli, një imazh i realitetit social, një mjet i shkëmbimit politik, një burim mobilizues aspirimi, dhe gjithashtu një pajisje shpjegimi politik dhe historik".

Përqëndrimi rreth konceptit të lirisë mund të gjurmohet që në lindjen e Shteteve të Bashkuara si popull e shtet-komb, që ishte Republika e parë që çliroi veten nga pushteti kolonial i një fuqie europiane. Rrjedhimisht, emancipimi dhe liria janë bërë pjesë e

narracionit historik amerikan. Për shëmbull, Tomas Pein, që kemi përmendur më herët, tek "Fryma e Përgjithshme", shkruan gjithashtu se Amerika duhet të bëhej "azili për të dashuruarit e persekutuar të lirisë civile dhe fetare".

Originaliteti i kësaj deklarate të lirisë së vërtetë nuk është e rëndësishme këtu, por rëndësi i jepet faktit që për shkak të natyrës revolucionare me anë të së cilës Amerika u bë një shtet pavarur, liria u bë vlera më e rëndësishme me anë të së cilës të gjithë amerikanët e përkufizojnë veten. Kur Amerika fitoi statusin e një fuqie të madhe dhe filloi ta ushtronte këtë fuqi në skenën botërore, politikat e huaja filluan të vendosen në kontekstin e gjuhës së lirisë: Për përfshirjen e Amerikës në Luftën e Parë Botërore, presidenti Vudrou Uillson foli për nevojën e "të ndëtuarit një botë përfundimisht të lirë"; Presidenti Frenklin D. Ruzvelt e përkufizoi përfshirjen amerikane në Luftën e Dytë Botërore si një zgjedhje mes "skllarërisë njerëzore dhe lirive njerëzore".

Demokracia qëndron e lidhur ngushtë por gjithsesi e ndarë nga ideja e lirisë në kompleksin e sistemit amerikan të vlerave. Demokracia shpesh përdoret në mënyrë sinonime me lirinë në fjalimet politike amerikane duke u vlerësuar si mishërimi më i vërtetë politik dhe mishërimi filozofik i lirisë, dhe ideologjia amerikane në vetvete është shembullore për shkak të demokracisë. Besimi i përgjithshëm është që Shtetet e Bashkuara janë një komb i dedikuar në mënyrë origjinale parimeve dhe praktikave të demokracisë. Pas Luftës së Dytë Botërore, Amerika mori rolin e liderit të botës demokratike e kapitaliste, kundër asaj që u perceptua si kamxhiku i pushtetit totalitar komunist.

Amerika ishte përgjigja e kërcënimit të madh komunist, gjë që ndihmoi gjithashtu në përkufizimin e pozicionit të Amerikës si ideologjia kundër ideologjisë "së Tjetrit". Konceptet amerikane të lirisë dhe demokracisë dhe nderimi që i bënin amerikanët këtyre vlerave, lidhur bashkë me një përkushtim ideologjik të këtyre vlerave në çështje të politikave të jashtme, ka sjellë si rrjedhojë një karakteristikë tjetër të rëndësishme të përveçësisë amerikane: iluzionin e mirësisë. Hunt argumenton se besimi amerikan është i përcaktuar në të tillë mënyrë: "Aty ku të tjerët kërkojnë të shfrytëzojnë dhe të shtypin... amerikanët kërkojnë vetëm të mbrojnë dhe të udhëheqin". Kjo nuk është një risi për politikat e jashtme

amerikane dhe ka formuar një komponent shumë të rëndësishëm në mënyrën në të cilën amerikanët kanë shpallur përveçësinë e tyre. Për shembull, presidenti Uillson deklaronte shpesh se ishin Shtetet e Bashkuara që "nuk kishin motive egoiste" kur i krahasonte politikat e jashtme amerikane me ato të fuqive europiane (Hodgson, 2006:92). Kjo vjen nga një besim origjinal i trashëguar në përveçësinë amerikane që nuk është vetëm përgjegjësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që të promovojë lirinë dhe demokracinë, por është qëllimi i saj moral dhe është manifestim i fatit.

Elementi më i goditur i politikës së jashtme amerikane, që përcakton një element të rëndësishëm dhe të dallueshëm në të, është që ajo është e kufizuar në terma të detyrës morale. Siç ka argumentuar Lipset, *"Amerikanët e përcaktojnë rolin e tyre në një konflikt në anën e Zotit kundrejt anës së Satanit, për moralitetin kundër së keqes"*, dhe Amerika është, shton ai, "shteti më i moralshëm në botën e zhvilluar". Këtu shohim sërish një pjesë të identitetit amerikan që plotëson dhe përforcon elementë të tjerë të tij, që janë të pandashëm nga krijimi i kombit amerikan. Vendi i moralizimit e ka origjinën në historinë e eksperiencës fetare të Shteteve të Bashkuara. Barbara Hinckley ka argumentuar që presidenti është qendra e universit të moralit amerikan sepse "ata predikojnë, duke i rikujtuar popullit amerikan parimet morale dhe fetare dhe duke i nxitur ata të sillen në sipas këtyre parimeve" Presidenti F.D. Ruzvelt publikisht ka kërkuar për "udhëheqje hyjnore...që t'u japë dritë atyre që qëndrojnë në errësirë" (Fjalimi i Pranimi të Mandatit të Dytë 1937); Presidenti Nikson ka kërkuar për mbështetje prej amerikanëve me lutje "që në vitët që vijojnë unë të kem ndihmën e Zotit që të marr vendimet e duhura për Amerikën" (Fjalimi i Pranimi të Mandatit të Dytë). Presidenti Ronald Regan ka folur që Amerika të bëhet një "komb nën Zotin, dhe unë besoj se Zoti kishte si qëllim që ne të ishim të lirë" (Fjalimi i Pranimi të Mandatit të Parë); dhe Presidenti Bill Klinton, në Fjalimin e tij të Pranimi të Mandatit të Parë tha "Ne jemi në një kohë ndryshimi. Dhe tani, secili në rrugën e ti, dhe me ndihmën e Zotit, duhet t'i përgjigjemi kësaj thirrjeje". Në kombe të tjera demokratike e laike, fjalime të tilla për Zotin nga politikanët janë të paimagjinueshme, por në Amerikë, siç Foley argumenton, *"sfera e moralit dhe politikës janë kaq shumë të përziëra sa që mbeten të padallueshme nga njëra-tjetra"*.

Vlerat amerikane të lirisë dhe demokracisë e humbasin statusin shembullor kur kuptohen në kontekstin e sfondit të krishterë amerikan. Amerikanët u bënë shpëtimtarë. Politikat e jashtme amerikane në kohë të ndryshme është lëkundur mes një impulsi drejt izolimit dhe një impulsi më të fortë të obligimit misionar. Në vitet ndërmjet luftërave, për shembull, internacionalizmi i Uillsonit u kritikua ndjeshëm dhe publiku dukej se ishte dakord me këtë kritikë. Kur vlerat e misionarëve të parë të krishterë u integruan në politikat e jashtme amerikane, rezultati që erdhi ishte një absolutizëm shqetësues dhe hipokrit që shërbeu për të armiqësuar njerëz të tjerë dhe për të penguar arritjen e qëllimeve strategjike legjitime.

Këtë ndjenjë përveçsie, dhe misionarizmi, amerikanët e kanë shfaqur hapur përgjatë gjithë historisë së tyre në marrëdhënie me shtet-kombet e tjera. Këtë do ta ilustrojmë dhe analizojmë, përmes disa momenteve tipike të projektimit të identitetit amerikan në arenën ndërkombëtare. Për të nisur me këto shembuj, do të huazojmë pasazhine mëposhtëm nga teoricieni i konstruktivizmit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Alexander Wendt (Anarchy is what states make of it):

“Shtetet sillen ndryshe me armiqtë e ndryshe me miqtë e tyre, për shkak se armiqtë janë kërcënues, e miqtë jo. Anarkia dhe shpërndarja e fuqisë nuk mjaftojnë për të na treguar se çfarë është çfarë. Fuqia ushtarake e SHBA-së, ka një domethënie tjetër për Kanadanë dhe një tjetër për kubën, paçka pozitave të tyre “struktorore”, njësoj sikurse raketat britanike kanë një tjetër domethënie për Shtetet e Bashkuara, nga ajo që kanë raketat sovjetike. Shpërndarja e fuqisë, mund t’i afektojë gjithmonë llogaritë e shteteve, por mënyra emkëtij afektimi varet prej të kuptuarit të ndërsjelltë dhe pritshmërive të ndërsjellta lidhur me shpërndarjen e njohurisë, e cila përbën konceptimin e vetes dhe tjetrit”.

Mirëpo për të kuptuar narrativën amerikane në marrëdhëniet ndërkombëtare, duhet të ribëjmë udhëtimin që kemi bërë në çdo kapiyull, retrospektivë dhe introspektivë në historinë e Amerikës.

Presidenti Uashington ishte ipari që nisi një model neutraliteti për Amerikën, teksa i qëndroi larg vazhdimin të luftës Franko-Britanike. Mirëpo nga ana tjetër, shihej nevoja e ndërtimit të një flote për mbrojtje nga pirateria në det. Të njejtën politikë vijuan edhe presidentët Adams, Xheferson, dhe Medison. Presidenti Monro, shpalli si politikë të jashtme atë që njihet gjerësisht si Doktrina Monro. Praktikisht, presidenti i 5-të i SHBA-së argumentoi se cilido inkursion i shteteve europiane në drejtim të amerikave do të konsiderohëj menjëherë si një agresion ndaj SHBA-së. Duke shfaqur për herë të parë tendencat misionare të amerikës si shpëtimtare dhe mbrojtëse e madhe. Kjo politikë izolacioniste u vijua edhe gjatë presidencave J.Q. Adams, Xhekson, Van Buren, dhe Harrison. Me ardhjen e presidentit Tajler, u përcaktuan kufinj të me Kanadanë, si dhe nisën marrëdhëniet diplomatike me Kinën e Meksikën. Politika që vazhduan edhe gjatë presidencës Polk, Tejlor, dhe Fillmore. Gjatë presidencës Pirs, u dukën hapur tendencat ekspansioniste të amerikës lidhur me Kaliforninë, Nju Meksikon dhe Teksasin. Gjatë kësaj presidencë pati edhe tentativa për ta blerë ose pushtuar Kubën. E njëjta frymë vijoi edhe gjatë presidencës Bukanan. Politika e jashtme e Linkolnit u fokusua tek ruajtja e marrëdhënieve tregtare me shtetet e huaja, dhe me kujdesimin që shtetet e konfederatës të mos merrnin mbështetje prej ndonjë shteti tjetër. Presidencë e Endriu Xhonsonit gjithashtu u përqendrua tek çështjet e brendshme sikurse ajo e Linkolnit, por vlen të përmendet blerja e Alaskës, prej Ruisë, që asokohe u konsiderua absurde, por që në vazhdim të historisë është konsideruar një prej momenteve më të jashtëzakonshme gjeostrategjike duke mbajtur parasysh kohërat që do të vinin. Gjatë presidencës Grant po ashtu u provuan aneksime të ishujve amerikano-qendror.

Gjatë presidencës Hejs, për herë të parë lindi nevoja për një marrëveshje për kontrollimin e emigracionit. Kjo erdhi pas komuniteti kinez në Amerikë, që vinte nga paqësori ishte rritur eksponencialisht. Kontrolli nuk u kërkua aq shumë për shkak se nuk mund "t'i bëhej një vend" më shumë emigrantëve, por sepse sikurse dokumentohet (Arnesen, 2007:240), kinezët vinin në Amerikë vetëm për të punuar dhe nuk integroheshin as në jetën sociale, as kulturore, e aq më pak politike. Amerikanët i mbajtën kinezët nën

kontroll përmes Akteve të Kongresit deri në vitin 1943. Presidencat Garfield, Artur, Harrison dhe Klivlend, u rifokusuan tek Doktrina Monro duke ruajtur sidoqoftë marrëdhëniet tregtare tashmë të konsoliduara me shtetet më të fuqishme të globit.

Gjatë presidencës Mek Kinli, Doktrina Monro, jo vetëm që u aplikua menjëherë për të shpëtuar Kubën nga Spanjollët, por u shndërrua në imperializëm, kur Amerikanët vendosën të mbanin Puerto Rikon, Filipinet dhe Guamin, si trofe i fitores ndaj perandorisë spanjolle në rënie. Kështu nisi edhe fillimi i shekullit të njëzetë për SHBA-në, tashmë me një identitet të ri ndërkombëtar, atë të shpëtimtarit të madh, që nuk i fsheh aspak ambicjet për hegjemoni. Ambicje, jo më të limituara në kontinentin e madh amerikan. Presidenti Teodor Ruzvelt erdhi në pushtet me politikën e qartë se Amerika duhet ta fuqizojë maksimalisht pozitën e saj ndërkombëtare dhe duhet të jetë gati që të mbrojë interesat e veta në të gjithë botën¹². Me T. Ruzveltin, kemi shpalljen e një politike të qartë realiste, duke e pranuar sistemin si anarkik, dhe duke mbajtur si parim suprem, maksimizimin e fuqisë së shtetit. Kësisoj, Amerika arriti që duke e projektuar veten si superfuqi të rriste në popull ndjenjën se vërtetë ushtria dhe fuqia amerikane duhet të rritej. Duke argumentuar, elita arriti që të bindte popullin që ta mbështeste rritjen ushtarake amerikane, dhe t'i konsideronte si shenja krenare fuqie bërjen e Panamasë një shtet të pavarur me qëllim që të hapej një kanal ujqor, tregtar që e ndante kontinentin në dysh dhe lidhte dy oqeanet e mëdhenj amerikanë. Kështu, edhe gjatë presidencës Taft, fill para Luftës së Parë Botërore, Amerika mundi që përmes fuqisë së madhe ekonomike të akumuluar nga tregtia dinamike, intensive dhe e hapur, di dhe përmes rritjes së fuqisë ushtarake e territoreve që kishte nën kontroll, të projektohej si superfuqia më e re dhe më solide e fillimshekullit.

Presidenti Uillson i dha Amerikës një metodë të re për të njëjtën përmbajtje. Një mjet të ri për të njëjtin qëllim. Presidenti Uillson, duke çimentuar botërisht bindjen se Amerika është e vetmja superfuqi që mund ta mbrojë dhe shpëtojë botën, realizoi dy arritje të mëdha në kuadër të projektimit të identitetit amerikan në marrëdhëniet ndërkombëtare. Së pari,

¹² Politika e Jashtme Amerikane e T. Ruzvelt <http://www.pbs.org/wgbh/americanexperience/features/general-article/tr-foreign/> (parw pwr herw tw fundit mw 19 qershor 2016, ora 12:40.)

edhe pse fillimisht i rezistoi hyrjes në luftë pavarësisht provokimeve, si një pacifist i vërtetë, presidentit iu desh më pas të elaboronte tezën “Le të hyjmë në një luftë që do t’iu japë fund të gjitha luftrave”. Ai më në fund e kishte kuptuar paevitueshmërinë e pjesëmarrjes në luftë. Në 1917, Amerika i shpall luftë Gjermanisë dhe bëhet kështu pjesëmarrëse në L.P.B. nën petkun e superheroit. Së dyti, me fjalimin e tij para Kongresit të njohur gjerësisht me titullin “14 pikat e Uilsonit” ai po e projektonte Amerikën, jo thjeshtë si pjesëmarrëse në marrëdhënjet ndërkombëtare, por si formësuesen e tyre. Taashmë përmes propozimit për ngritjen e Lidhjes së Kombeve, Amerika do të kishte mundësi të udhëhiqte për herë të parë në histori, një organizatë ndërkombëtare, ndërshtetërore e ndërqeveritare të këtyre përmasave. Lidhja e Kombeve ishte fundi i ndërtimeve të themeleve për një Amerikë hegjemone, dhe nisja e ndërtimit të fronit botëror. Kështu nisi projektimi mbarëbotëror i identitetit amerikan, si një fenomen të gjithëpranuar supremacist dhe dominues në arenën ndërkombëtare dhe diplomaci.

Presidencat Harding dhe Kulixh u treguan shumë pasive dhe me tendenca Monroiste. Presidenti Huver tentoi që ta rriste gjithëprezencën amerikane nëpër bptë, duke çuar anije me stacionim afatgjatë në brigjet e Azisë me justifikimin për mbrojtjen e jetës së qytetarëve amerikanë në Azi. Deri para L.D.B. politika e jashtme amerikane, edhe gjatë dy mandateve të para të F.D. Ruzveltit, u fokusua më tepër tek zhvillimi i diplomacisë dhe tek përhapja e propagandës për demokraci dhe anti-kolonializëm.

Në dhjetor 1941, sulmi i papritur japonez në Pearl Harbour, realizoi futjen *de facto* të Amerikës në L.D.B. Me gjithë forcën ushtarake, Amerika tregoi edhe forcë të madhe diplomatike duke nxitur dhe realizuar bashkë me Britaninë e Madhe dhe Bashkimin Sovjetik, tri konferenca të mëdha për luftën dhe paqen: Konferenca e Teheranit, Iran, 1943, me pjesëmarrjen e F.D. Ruzveltit, Çerçillit dhe Stalinit; Konferenca e Jaltës, B.R.S.S. 1945, me po të njëjtët përfaqësues ku planet e mbylljes së luftës u finalizuan dhe u hodhën themelet për Organizatën e Kombeve të Bashkuara; dhe Konferenca e Potsdamit, Gjermani, 1945, por tashmë me përfaqësues në takim Stalinin, Etlin për britanikët dhe Trumanin për Amerikanët. Presidenti Truman në gusht të 1945, do të jepte urdhrin për lëshimin e bombës

atomike në Hiroshima të Japonisë, e më pas në një qytet tjetër të vendit, Nagasaki. Marrëdhëniet ndërkombëtare ndryshuan që prej atij momenti. Tashmë Amerika ishte një superfuqi e frikshme. Luftbërja kishte ndryshuar një herë e mirë.

Pas Trumanit erdhi në presidencë Ajzenaueri i cili kishte qenë gjeneral në L.D.B. dhe kishte fituar një neveri ndaj luftës (Ambrose, 1990). Menjëherë amerikanët nisën ndihmat financiare kryesisht, ndaj vendeve të Europës, në formën e donacioneve ose borxheve të buta, duke u riprojektuar si prindi që kujdeset për rimëkëmbjen e fëmijëve. Tashmë mes aleatëve të dikurshëm, kishte nisur një rivalitet influencash, Amerika apo Bashkimi Sovjetik, demokracia apo komunizmi. Presidenti Kenedi, edhe pse me një presidencë tragjikisht të shkurtër u përball me Luftën e Ftohtë në një situatë të tensionuar të njohur si “Kriza e Raketave Kubane”, por të cilën Amerika e zgjidhi përmes kanaleve dytësore diplomatike. Një problem tjetër në projektimin e amerikanëve si shpëtimtarët suprem ndërkombëtarisht, kishte lindur në Vietnam. Në shtetin e largët e të vogël e të panjohur të Azisë, amerikanët po përpiqeshin që të fitonin ushtarakisht një betejë ideologjike. Problemi i Luftës në Vjetnam e zhyti jo vetëm politikën e jashtme, por edhe situatën e brendshme social-politike, në një batak të pamenduar për rreth 2 dekada¹³ Gjatë presidencave Kenedi, Xhonsn, Nikson, Ford. Politika e Jashtme e Niksonit, u karakterizua nga ajo që u quajt “Diplomacia Trekëndore” dhe që kishte për arkitekt Henri Kissingerin. Kjo nënkuptonte që Amerika po luante njëkohësisht ping-pong me Kinën dhe garë skish me Rusinë, duke i mbajtur të dyja në distancë më njëra – tjetrën, dhe duke i intimiduar prej mosnjohjes së bisedave reciproke. Në këtë mënyrë u realizua deterrenca prej konfliktit me anë të metodës “Detanta” (Kissinger, 1999:7W-34). Pas kësaj periudhe, presidenca Ford nuk pati ndonjë shkëlqim të madh në politikën e jashtme. Dështim konsiderohet nga studiuesit edhe politika e jashtme “e tërhequr” e presidentit Karter, i cili dha imazhin e një presidenti “të dobët” teksa në Iran u morën peng disa funksionarë të ambasadës dhe sovjetikët pushtuan Afganistanin.

¹³ Lufta në Vietnam <http://militaryhistory.about.com/od/vietnamwar/a/VietnamEnd.htm> (Parw pwr herw tw fundit mw 19 qershor 2016, 15:50)

Megjithatë, nuk mund të mohohet kontributi paqebërës i Karterit në realizimin e paktit Begin - Sadat.

Presidenti Regan, gjatë fushatës presidenciale të vitit 1980, kishte evokuar vazhdimisht “Qytetin e shndritshëm në kodër”, atë ideal të qytetit të prosperuar e harmonioz që amerikanët e kishin mbajtur në zemër që prej themelimit të shtet-kombit. Me ardhjen në krye të shtetit, politika e tij e jashtme aplikoi pikërisht filozofinë e kësaj thënieje. Ai fuqizoi ushtrinë më një çek të bardhë, dhe realizoi një garë armatimesh, me të cilën B.R.S.S-ja e topitur ekonomikisht, nuk mund të matej. Kjo garë, sidomos për dërgimin e satelitëve dhe misioneve në hapësirë, për të dhënë imazhin e hegjemonit përtej Tokësor, u quajt “Lufta e Yjeve” (Star Wars” dhe pati si fituese Amerikën. Kjo fitore mund të përkufizohet në disa rreshta që Pegi Nunan, fjalimshkruesja e më pas biografja e Reganit, na paraqet (Noonan, 2015:319):

“... Gorbaçovi e bëri publike letrën e fundit drejtuar Reganit, duke ia treguar letrën botës përpara se ajo të mbërrinte tek Regani. Ishte diçka befasuese, edhe nëse ishte thjesht propagandë, ajo e gëzoi botën. Bashkimi Sovjetik do t’i çinstalonte të gjitha raketat e veta me forcë të mesme që kishte nëpër Europë, do të pranonte një moratorium mbi provat bërthamore dhe do të shqyrtonte shkatërrimin e të gjitha armëve bërthamore nga të dyja palët, brenda fundit të shekullit... në shkëmbim të diçkaje të vetme. Që Shtetet e Bashkuara të ndalonin “zhvillimin, testimin dhe instalimin e armëve që godasin prej hapësirës”

Pas fitores së Luftës së Yjeve nga Regani, me ardhjen e presidentit G.H.W. Bush të gjithë prisnin goditjen përfundimtare ndaj Bashkimit Sovjetik, dhe ajo erdhi. Presidenti Bush Sr. Ishte gjithashtu i suksesshëm në operacionet ushtarake në Panama, Somali e sidomos në Luftën e Gjirit Persik, kundër Irakut. Me rënien përfundimtare të komunizmit, presidenti Bush shpalli hapur Rëndin e Ri Botëror, ku demokracia kishte triumfuar, ku në fakt Amerika kishte triumfuar, dhe ku do të triumfonte sa herë që nje shtet apo regjim të sulmonte demokracinë, kudo që ajo të ishte nëpër botë. Kësisoj, u shpall përfundimisht hegjemonia amerikane, e cila edhe sot bën të mundur justifikimin e cilitdolloj veprimi apo sjelljeje që Amerika ndërmerr në arenën ndërkombëtare. Presidenca Clinton, nisi pikërisht aplikimin e

kësaj hegjemonie duke ndërhyrë kështu sikurse kishte ndodhur në Vietnam, për të zgjidhur luftërat civile në Somali dhe Rwanda përmes forcave paqeruajtëse të OKB-së, dhe Bosnjë e Kosovë më pas.

Presidenat G.W. Bush Jr. dhe Obama, do të përshkohen prej terrorizmit të sekteve islamike të lindjes së mesme, ndaj amerikës, pikërisht si simbol i kundërpërgjigjes së këtyre vendeve ndaj shtypjes politike, ekonomike e kulturore që Amerika u ka ushtruar atyre. Presidenti Bush, në gjueti hakmarrëse ndaj terroristëve të 11 shtatorit 2001, zhvilloi menjëherë dy luftëra, fillimisht në Afganistan 2002 e më pas në Irak 2003. Presidenca Obama, u dedikua që të mbyllte luftat e nisura kundër terrorizmit, si dhe të bllokonte zhvillimin dhe përhapjen e mëtejshme të armëve bërthamore, sidomos ndaj potencialit nuklear të Iranit.

E gjithë pasqyra historike e mësipërme na mundëson drejtëpërdrejt të shohim se si kohë pas kohe, përgjatë gjithë narrativës së politikës së vet të jashtme, Amerika, ka mundur që ta projektojë veten si një komb ndër kombë, si një ideal, si një përveçësi së cilës i duhet prej natyre të jetë hegjemone dhe të ushtrojë supremaci si dhënësja e drejtësisë finale. Sipas Paul Saurette, *“Politika e jashtme amerikane duhet kuptuar si një praktikë politike në nivel makro, për prodhimin dhe ruajtjen e identitetit amerikan”*. Sot në amerikë ka një debat dhe dilemë të madhe politike midis atyre që konsiderohen si nacionalistë ose neoizolacionistë, dhe mes atyre që konsiderohen intervencionistë që kryesisht janë mbrojtësit e idesë së eksportimit të demokracisë dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, pasqyra historike na tregon, se Amerika nuk e ka rastësisht këtë pozitë globale. Ata u vetëprojektuan për të qenë këtu ku janë sot.

KAPITULLI V: PËRFUNDIME

Fillesat e Amerikës, sikurse na thotë thjeshtë e qartë edhe Theçeri në nisje të këtij punimi, janë *sui generis* në histori. Për shkak të ngjarjeve politike e fetare në Kontinentin e Vjetër, shumë njerëz, fillimisht anglosaksonë, e më pas nga e gjithë Europa, e panë Tokën e Re si një mundësi për rifillim. Prej analogjive me utopitë e shkruara derimë atëhere, si pasojë e nisjes së epokës moderne në mendimin njerëzor, shumë njerëz nisën ta përfytyronin kontinentin amerikan si një vend ku vërtetë mund të ndërtohej një shoqëri sikurse Atlantida e Re. Mbi filozofinë laike të së drejtës sipas Xhon Lokut. Prej kësaj, mund të arrimë në përfundimin se edhe pse marrëdhëniet ndërkombëtare ishin në një fazë fillestare kur bota porsa po lidhej si një e vetme, Amerika shëmbëlleu kudo si një model i ri për t'i shpëtuar regjimit të vjetër.

Më tej, revolucioni amerikan, nuk ngjasonte me asnjë prej revolucioneve që ndodhën më pas në kontinentin e vjetër. Revolucioni amerikan sikurse argumentonte edhe Bërku, nuk erdhi sepse amerikanët donin të ndryshonin status quo-në, por sepse status quo-ja e tyre po ndryshonte prej sanksioneve, dhe taksave të reja që po vendoste kryeqyteti perandorak. Kësisoj, në ndryshim përshembull nga Revolucioni Francez, që i pranëvendoset atij amerikan në kontekst historik, Revolucioni Amerikan ishte një revolucion konservator, i djathtë i cili kërkonte të ruante gjendjen, të ruante sferën tregtare dhe lirinë e individit nga dora e shtetit. Revolucioni francez ishte një revolucion që nuk e donte gjendjen, donte ta përmbyste dhe jo ta ndryshonte, nuk interesohej për njeriun, por për sistemin. Revolucioni amerikan, nuk u realizua si një pakënaqësi e fshatarsisë dhe e të varfërve kundër shtresës së pasur, pronarëve dhe oborrit mbretëror. Prandaj dhe Revolucioni Amerikan nuk ishte një revolucion progresist, por konservator.

Së treti, gjatë ndërtimit të shtetit deri në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë, amerikanët u përqendruan tek intensifikimi i marrëdhënieve tregtare përtej oqeanit, dhe me zgjerimin e territoreve të tyre deri në Paqësor. Përgjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, shteti amerikan, ishte një prej modeleve më të suksesshme politike dhe shoqërore. Kjo jo vetëm për shkak të

territorit të madh dhe suksesit tregtar të amerikanëve, por sidomos për shkak të ndërtimit të institucioneve mbi frymën e demokracisë kushtetuese dhe ndarjes së qartë të pushteteve me parimin “kontroll dhe ekuilibër”. Institucionet amerikane u bënë shpejt një model edhe për demokraci të tjera në Europë dhe në pjesën tjetër të botës.

Së katërti, amerikanët, në kapërcim të shekullit u shfaqën si një shtet me ndarje të qartë mes zonave urbane dhe rurale, me teknologji të përparuar për kohën, shtet i industrializuar, me infrastrukturë transporti të shpejtë dhe të kudondodhur. Ushtarakisht ata e treguan forcën kundër Spanjës në mbrojtje të ishujve të Amerikës Qendrore. Marrëdhëniet diplomatike ishin zhvilluar me thujtë çdo shtet të asokohshëm të rruzullit.

Fillimishtekulli i njëzetë i pa amerikanët që të projektoheshin si populli më demokratik dhe paqëndashës që shpëtoi Europën prej luftës së tmerrshme ku e kishte futur veten. Me përfundimin e L.P.B. amerikanët morën natyrshëm rolin e udhëheqësit të politikës botërore përmes organizatës së parë ndërkombëtare ndërqeveritare, Lidhjes së Kombeve. Lufta e Dytë Botërore e përforcoi dhe konsolidoi imazhin botëror të Amerikës si i vetmi shtet që mund të fitonte cilëndo luftë.

Së pesti, periudha e luftës së ftohtë i projektoi amerikanët si mbrojtësit botërorë të lirisë dhe demokracisë së të gjithë njerëzve pavarësisht se ku ata jetonin, kështu vlerat amerikane u universalizuan si vlera të cilat në fakt duhet t’i përfaqësojnë hap pas hapi i gjithë globi, dhe armiku i këtij procesi ishte komunizmi lindor. Ndihma e amerikanëve për popujt e botës që kërkonin liri nuk ishte vetëm politike, por edhe mbështetje ushtarake, humanitare e sidomos financiare. Flota amerikane, deri në fund të shekullit arriti që ta bënte amerikën të kudondodhur.

Së gjashti, SHBA, e nisën mijëvjeçarin e ri, si një entitet tokësor që përngjasonte me atributet e pashoqe të Zotit: **Kudondodhja** (Flota detare, shërbimi sekret, ushtria, diplomacia), **Gjithpushtetshmëria** (supremacia ushtarake, dominimi i politikës ndërkombëtare përmes medias dhe fuqisë financiare, dominimi i organizatave ndërkombëtare si OKB, etj.) **Sovraniteti** (e justifikuar për të vepruar në çdo vend dhe në çdo kohë, si mbrojtëse e të drejtave të njeriut, pa asnjë kufizim përballë sovranitetit të

shteteve të tjera.) **Gjithëdija**, (grumbullimi dhe nxitja e mendjeve më të mëdha të njerëzimit përmes universiteteve më të mira në botë dhe një mjedisi akademik e intelektual të lirë, të shumërespektuar dhe kompetitiv.) **Adhurimi** (përmes filmave, modës, artit, dhe medias, Amerika e projekton veten globalisht si një shoqëri e cila duhet të adhurohet si toka e ëndrrës së njerëzve të thjeshtë)

Në fund, lufta dy dekadave postmileniale të amerikanëve kundër terrorizmit botëror e ka zbehur disi shpresën tek Amerika si shpëtimtare dhe i ka dhënë shtetit amerikan një imazh disi arrogant dhe jo aq dashamirës. Sidoqoftë, për shumë shtet-kombe Amerika vazhdon të shihet si një model politik dhe si një burim për mbështetje politike ndërkombëtare. Për shumë popuj, kultura dhe identiteti amerikan ngjall shpresë se diversitetit mund të jetë boshti i harmonisë dhe bashkëjetesës njerëzore. Në këtë vit zgjedhor për Amerikën, e gjithë bota i ka kthyer sytë për të kuptuar se çfarë ndryshimesh do të ndodhin nga njëra presidencë në tjetrën, për të kuptuar përmes kësaj se cilat do të jenë impaktet kulturore, sociale, ekonomike, politike dhe diplomatike në të gjithë botën. Ky tregues na mjafton për tu bindur se elementet e përfundimit të mëparshëm janë më të forta se kurrë.

BIBLIOGRAFIA

- Allyn, D. (2000). *Make Love, Not Ęar: The Sexual Revolution: An Unfettered History*. Nju Jork: Routledge.
- Ambrose, S.E. (1990). *Ajzenauer*. Tiranĕ, Shqipĕri: Shtĕpia Botuese e Ushtrisĕ.
- Anderson, B. (2013). *Komunitete imagjinare*. Elbasan, Shqipĕri: Dy lindje dhe dy perĕndime.
- Baudrillard, J. (1986). *America*. Londĕr, Mbretĕri e Bashkuar: Verso.
- Bender, T. (2006). *A Nation Among Nations: America's Place in Ęorld History*. Nju Jork: Hill and Ęang.
- Boas, F. (1922). *Report on an Anthropometric Investigation of the Population of the United States*. SHBA: Journal of the American Statistical Association.
- Boas, F. (1940) *Race, Language, and Culture*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Burke, E. (2007) *Refleksione mbi revolucionin francez*. Tiranĕ, Shqipĕri: ISP & Dita 2000.
- Cooke, J.E. Klein, M.M. (1998). *North America in Colonial Times: An Encyclopedia for Students*. Londĕr, Mbretĕri e Bashkuar: MacMillan Publishing Company.
- Cottrol, R. (2013). *The Long, Lingerinĝ Shadoĕ: Slavery, Race, and Laĕ in the American Hemisphere (Studies in the Legal History of the South Ser.)*. Athens, Georgia: University of Georgia Press.
- Davies, N. (1996). *Europe: A history*. Oxford, Mbretĕri e Bashkuar: Oxford University Press.
- Draper, T. (1996). *A Struggle for Poĕer: The American Revolution*. Nju Jork, SHBA: Vintage Books.
- Escoffier, J. (2003). *Sexual Revolution*. Nju Jork: Thunder's Mouth Press.
- Fiorina, M.P. (1998) *The Neĕ American Democracy*. Nju Jork: Pearson.
- Fischer, D.H. (2005). *Liberty and Freedom: A Visual History of America's Founding Ideas (America: a cultural history)*. Nju Jork: Oxford University Press.

- *Historia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës*. Tiranë, Shqipëri: Qendra Ndërkombëtare e Kulturës.
- Hodgson, G. (2006). *Ëoodroë Ëilson's right hand: the life of Colonel Edëard M. House*. SHBA: Yale University Press.
- Isseman, M. (2012). *America Divided: The Civil Ëar of the 1960s*. SHBA: Oxford University Press.
- Jackson, R. Sorensen, G. (2009). *Introduction to International Relations: Theories and Approaches*. Oxford, Mbretëri e Bashkuar: Oxford University Press.
- Kissinger, H. (1999). *Diplomacia*. Tiranë, Shqipëri: CEU University Press.
- Labaree, B.Ë. (1979). *The Boston Tea Party*. Northeastern.
- Maldëyn, J. (1993). *Storia degli Stati Uniti d'America. Dalle prime colonie inglesi ai giorni nostri*. Milano, Itali: Bompiani.
- Middlekauff, R. (2005). *The Glorious Cause: The American Revolution, 1763-1789*. Oxford, Mbretëri e Bashkuar: Oxford University Press.
- Morris, R.B. (1965). *The Peacemakers: The Great Poëers and American Independence*. Neë York: Harper & Roë.
- Noonan, P. (2015). *Ronald Regan*. Tiranë, Shqipëri: AIIS.
- Patman, R.G. (2007). *The Ethics of Foreign Policy (Ethics and Global Politics)*. Nju Jork: Routledge.
- Pejn, T. (2014). *Fryma e përgjithshme*. Elbasan, Shqipëri: Dy lindje dhe Dy perëndime.
- Poëell, J. F. (2005). *The First Americans: Race, Evolution, and the Origin of Native Americans*. Cambridge, Massachusetts: Cambridge University Press.
- Spraggon, J. (2003). *Puritan Iconoclasm During the English Civil Ëar*. Ëoodbridge, Virginia: The Boydell Press.
- Stevenson, P. (1989). *The American Civil Ëar*. Argus Books.
- Toqueville, A. de. (1935). *De la démocratie en Amérique*. Paris, Francë: Librairie de Charles Gosselin.

- Ëëndt, A. (1992). *Anarchy is èhat states make of it*. SHBA: International Organization Journal.
- Èhite, R. (2002). *Lincoln's Greatest Speech: The Second Inaugural*. Nju Jork: Simon & Schuster.
- Young, A. (1841). *Chronicles of the Pilgrims Fathers of the Colony of Plymouth from 1602 to 1625*. Boston, Massachusetts: C. C. Little and J. Broën.